

**UNITED
NATIONS**
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 23.2.2006

T R A N S K R I P T
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 23.02.2006.GOD.

SHKURT – FEBRUAR 2006

Seanca u mbajt në sallën e seancave plenare të Kuvendit të Kosovës dhe filloi në orën 10.

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit të Kosovës, kurse i ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

U lutem deputetëve t'i zënë vendet e veta, në mënyrë që të fillojmë. Të pranishëm në sallë janë 81 deputetë. Seancën mund ta fillojmë.

Mirëmëngjesi. Ju dëshiroj mirëseardhje në seancën e sotme. Tash në sallë janë të pranishëm 91 deputetë .I keni marrë të gjitha materialet sipas rendit të ditës me kohë. Janë të paraqitur për diskutim Jonuz Kastrati, Berat Luzha, Jakup Krasniqi, Besa Gaxherri, Nazim Jashari, që të gjithë janë përpara të paraqitur. Urdhëroni Jonuz Kastrati, e keni fjalën.

DEPUTETI JONUZ KASTRATI

Ju faleminderit, i nderuari kryetar, të nderuar ministra dhe ju deputetë. Dje qytetarët e komunës së Malishevës kaluan një ditë mjaft të vështirë. Një numër i konsiderueshëm i banorëve, si dhe një numër jo i vogël i fshatrave, ishin të shpëputur nga qendra komunale. Dje lumi Mirusha nuk kishte shtrat, i ngjasonte liqenit dhe pothuajse i tërë pellgu ishte shtrat i tij -sidomos fshatrat e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të lumit ishin të bllokuara tërësisht. Këto fshatra gjatë tërë ditës nuk kishin qasje në telefoninë mobile, si dhe pjesën më të madhe të ditës nuk kishin as rrymë. Mësimi u zhvillua me shumë vështirësi , e sidomos mësimi në Gjimnazin e Malishevës është mbajtur me vështirësi të mëdha, sepse punëtorëve dhe nxënësve vërshimet dhe përmbytjet ju kishin pamundësuar ardhjen në shkollë Fatbardhësisht nuk ka pasur humbje të jetës së njerëzve, prandaj na lejohet të themi se ka pasur mjaft dëme materiale e të cilat mbetën të vlerësohen më vonë. Që në të ardhmen të mos pësohet diçka edhe më e rënd, duhet ta kemi parasysh mundësinë e rregullimit të shtratit të lumit Mirusha, që do të ishte një investim mjaft i qëlluar. Në fund me kënaqësi do t'i falënderoja TMK-në dhe SHPK-në e Malishevës për kontributin që dhanë për përballimin e gjendjes së vështirë në Malishevë. Këta qytetarë kanë nevojë t'u zgjatet dora dhe duhet t'u zgjatet. Ju faleminderit kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Z. Kastrati ju faleminderit, fjalën e ka Jakup Krasniqi. Të përgatitet Besa Gaxherri.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

Z. kryetar, të nderuar deputetë.

Grupi Parlamentar i PDK-së edhe një herë përsërit kërkesat e veta për funksionalizimin e Kuvendit të Kosovës, në mënyrë që ky të jetë në krye të detyrave dhe të përgjegjësive që i kemi marrë nga qytetarët e Kosovës në zgjedhjet e lira.

Jemi të bindur se dinamika e punës së udhëhequr nga Kuvendin ynë është në shpërputhje të plotë me interesin e qytetarëve të Kosovës dhe të vendit, prandaj edhe një herë kërkoj nga Kuvendi dhe nga të gjitha grupet parlamentare të mëdha e të vogla të na mbështetin në kërkesat tona të drejta, që janë në shërbim të legjislativit dhe proceseve politike që po zhvillohen në Kosovë.

Vazhdimi i punës së Kuvendit në seanca mujore deri me tash shumë herë u vërtetua se Kuvendi nuk mund të jetë në ballë të proceseve. Kjo na obligon që edhe një herë ta ngremë zërin dhe të kërkojmë intensifikimin e punës në Kuvendin e Kosovës. Duke parë se në këtë seancë nuk kemi shumë punë, do të ishte në interes të Kosovës, të procesit politik që t'i trajtojmë me procedurë të shpejtë 2 – 3 çështje të rëndësishme politike dhe ekonomike.

1. Çështjen e standardeve, për të cilën u fol kohëve të fundit edhe në Këshillin e Sigurimit, ku u kritikuan Qeveria dhe institucionet e tjera të Kosovës. Këto vërejtje kanë një histori që nga 23 maji i vitit 2005. Mandej edhe vizita e fundit e Barozës që kishte një kritikë të ashpër ndaj institucioneve të Kosovës ndaj mos përmbushjes së standardeve. Jemi të bindur se kjo çështje duhet të hyjë në mënyrë të ngutshme në Parlament që Qeveria të japë përgjegjësinë e saj ,pse janë këto kritika dhe pse ka ngecje të dukshme në përmbushjen e standardeve, kur dihet se ato ndikojnë drejtpërsëdrejti e negativisht në procesin politik që po zhvillohet në Kosovë dhe për Kosovën.
2. Një çështje tjetër, që mendojmë se është e ngutshme- besojmë se është edhe fundi- është çështja e privatizimit. Privatizimi në shumë raste në vitet e fundit ka pasur ndryshime pozitive, por edhe dobësi. Jemi të bindur se në Kosovë jo gjithçka duhet të privatizohet, jemi të bindur se në shtetin e ri të Kosovës duhet ta kemi një strategji të mbrojtjes së pasurisë kombëtare . Këtë duhet ta bëjë Kuvendi, Qeveria nuk e ka bërë deri më tani. Jemi të bindur se minierat dhe disa ndërmarrje publike fitimprurëse duhet ta kenë statusin e ndërmarrjeve së interesit të veçantë kombëtar. Këtyre do tu shtohen edhe objektet e trashëgimisë kulturore, nëse synojmë ngritjen e punësimit dhe mbrojtjen sociale të një kategorie të qytetarëve na duhet që diçka të jetë pasuri kombëtare dhe të udhëhiqet nga Qeveria e Kosovës. Këtë mund ta bëjmë tani, sepse nesër mund të jetë vonë. Problem në vete është privatizimi i Feronikelit. Në këtë proces janë shkelur shumë herë shumë procedura dhe po të krahasohej me tenderin e telefonisë mobile, për tenderin e Feronikelit ka më shumë parregullsi dhe po të shtrohet pyetja: “Pse për probleme dhe shkelje të procedurave të veçanta, ndonëse në rastin e Feronikelit janë shkelur shumë herë procedurat, përdoren kut të ndryshëm nëse krahasohet me tenderin e telefonisë mobile”. Shpresojmë se kërkesat tona janë edhe tuajat dhe presim mbështetjen tuaj. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Z. Krasniqi, ju faleminderit. Një informacion ,ju lutem sepse i është premtuar edhe seancës plenare edhe Kryesia e ka pasur në fundit që do të dinamizohet puna e Kuvendit në kuptimin e numrit të seancave mujore. Propozimi nismëtar është i gatshëm në zyrën time. Pas kësaj seance plenare Kryesia e parë do ta ketë këtë dokument në dorë,që pastaj do t'u jepet edhe grupeve parlamentare dhe seancës plenare. Janë iniciuar në Kryesi disa çështje jo vetëm të PDK-së, por edhe LDK-së, çështja e privatizimit të vendoset, pastaj edhe çështja e standardeve, që të gjitha këto dhe çdo gjë që i intereson seancës plenare, përkatësisht çdo gjë që është pjesë e jetës në Kosovë do të jetë e debatueshme. Do t'jua them mendimin tim; as privatizimi e as standardet nuk janë urgjente që sot duhet të vendosim, por do të jetë çështje e rendit të ditës, propozimi është që seancat të jenë javore, por ta shihni një herë dokumentin, le të pësojë ndryshime dhe plotësime të komisioneve dhe grupeve parlamentare që i kanë dhe pastaj vazhdojmë me të. Fjalën e ka Besa Gaxherri, kurse le të përgatitet Berat Luzha.

DEPUTETJA BESA GAXHERRI

Faleminderit z. kryetar, kolegë të nderuar.

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet fuqishëm kërkesën e artistëve të Kosovës për objektin e Unionit që të shfrytëzohet për kulturën kosovare, njëkohësisht kërkon prononcimin e Qeverisë, kryesisht të kryeministrit dhe jo vetëm prononcimin, por kërkojmë nga Qeveria që t'i përkrah kërkesat e artistëve të Kosovës, se është momenti kur duhet të shihet forca vepruese dhe vendosmëria e kësaj Qeverie në këtë rast, për objektet kulturore të Kosovës, të kulturës në përgjithësi dhe respekt dhe përkrahje artistëve të Kosovës në veçanti me ato mundësi që i ka Qeveria në këtë moment.

Unë jam shumë e bindur se të gjitha grupet parlamentare e kanë të njëjtën kërkesë dhe e di pak a shumë ,procedurën e privatizimit, por megjithatë kërkoj nga Qeveria ta përmirësojë gabimin e vet, sepse është dashur me kohë të implikohet në këtë situatë e sidomos në këtë objekt që është vërtet objekt me vlera historike e kulturore . Kërkoj që ta përmirësojë gabimin e vet, pasi që e kemi edhe në bordin e AKM-së pjesën e Qeverisë, kemi edhe Ministrinë e Kulturës dhe kërkojmë që Qeveria urgjentisht të ulet të merret me këtë problem dhe të vendosë në të mirë të artistëve dhe të objektit kulturor. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Besa ,ju faleminderit dhe besoj se porosia është dëgjuar mirë. Fjalën e ka Berat Luzha, kurse le të përgatitet Nazim Jashari.

DEPUTETI BERAT LUZHA

Z. kryetar në mbledhjen e kaluar të Kuvendit, të mbajtur më 19 janar kam ngritur problemin e sapokrijuar të rrugës në Grykën e Kaçanikut. Duke e parë realisht problemin pata propozuar të miratoheshin 4 kërkesa. Edhe pse jeni pajtuar plotësisht me ato kërkesa, që i vlerësuat si të arsyeshme nuk janë miratuar dhe as votuar në Kuvend. Ndërkohë problemi vetëm sa është ndërlikuar. Rreth 15.000 banorë në këtë dimër të ftohtë e kanë kaluar të izoluar dhe me probleme të mëdha jetike. Bllokimi i rrugës i ka shkaktuar jo vetëm probleme, por edhe dëme të mëdha ekonomisë së brishtë të Kosovës, sidomos biznesit. Dëmet janë të një përmase të një katastrofe, janë alarmante për Kosovën, kurse gjendja e rrugës edhe pas 40 ditëve gjendet aty ku ka qenë në fillim në pikën **zero**. Në rrethana të pasqaruara dhe të dyshimta Qeveria ka angazhuar një kompani të vogël e të panjohur, që u pa se nuk ka kapacitete teknike dhe as të kuadrove për kryerjen e punëve shumë specifike. Puna e kryer deri më tash është bërë në mënyrë joprofesionale dhe pa seriozitetin e duhur e sidomos të Qeverisë. Asnjë qeveritar deri tash nuk i ka vizituar banorët e izoluar, as pilot komunën e Hanit të Elezit dhe as komunën e Kaçanikut që t'i shihte nga afër problemet e popullatës së kësaj ane, pas mbylljes së rrugës. Problemin e izolimit të një zone të tërë, Qeveria e ka injoruar në tërësi. Nuk është hapur asnjë kalim i përkohshëm emergjent, nuk është tentuar së paku të aftësohej rruga alternative Hani i Elezit- Qafë Shqipe që do ta zbuste dukshëm problemin, por që tash është shkatërruar edhe më shumë dhe është pamundësuar plotësisht kalimi nëpër të. Është për të ardhur keq se si Qeveria deri sot nuk ka bërë asnjë plan, projekt apo strategji për hapjen e rrugës, por ka punuar me vendime apo marrëveshje gojore. Duke e parë rëndësinë e madhe të problemit, propozoj që çështja e bllokimit të rrugës të shqyrtohet në këtë mbledhje si çështje urgjente, për të mos na zënë edhe mbledhjet e tjera me këtë problem. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Berat, besoj se kam qenë i qartë. E kam përkrahur plotësisht shqetësimin tuaj, sepse kam menduar njësoj dhe mendoj edhe tash, për të marrë vendim në asnjë moment nuk e kam thënë, sepse nuk mund të marrim vendim në bazë të një shqetësimi pa i parë materialet përkatëse e pa i dëgjuar të gjitha vërshtirësitë. Kjo brengë ishte edhe në Kryesi të Parlamentit dhe se ajo kërkoi të bëhej maksimumi, por nuk rekomandoi vendim, sepse janë organet përgjegjëse për atë, prandaj të gjithë të pranishmit ndien shqetësim sikur dhe e tërë popullata, por me gjithë këtë njerëzit që janë përgjegjës duhet t'i japin dhe i kanë dhanë sqarimet -sa i kamë përcjell mediat unë. Mirëpo nëse do të ketë nevojë le të hartohet një raport, sepse çështja është e ngutshme, por nuk është çështje që mund ta zgjidh Parlamenti pa e parë mendimin e të gjitha institucioneve të përfshira; të Qeverisë, të KFOR-it, të UNMIK-ute të TMK-së. Prandaj le të merret si ide, nuk them që nuk është çështje e ngutshme, por kur e shtrojmë si të ngutshme duhet të kemi edhe zgjidhje. Në qoftë se nuk kemi zgjidhje kot shqetësohemi, prandaj edhe Kryesia e ka debatuar këtë. Berat, u mendoj se nuk keni replikë me mua, por urdhëroni.

DEPUTETI BERAT LUZHA Mendoj se nuk mjaftojnë vetëm shqetësimet tona, por duhet të ndërmarrim masa. Kam propozuar në mbledhjen e kaluar që të formohet, së paku, një grup deputetësh, një delegacion, një komision, një grup pune i deputetëve që

do ta konstatonte gjendjen dhe do t'i propozonte masa Kuvendit dhe Qeverisë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Besoj se Komisioni për Çështje Emergjente e kryetari kanë raportuar në Kryesi dhe është duke punuar .Ka pasur takim,sa e di unë, të mërkurën,në agjendën e tyre, prandaj fjalën e ka Nazim Jashari , le të përgatitet Gjylnaze Syla.

DEPUTETI NAZIM JASHARI

Z. kryetar nuk kam ndonjë fjalë jashtë rendit të ditës. Fjala ime ka të bëjë me pikën e parë të rendit të ditës,prandaj deri atëherë tërhiqem.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ju faleminderit, fjalën e ka Gjylnaze Syla , le të përgatitet Haxhi Merxha

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

Ju faleminderit z. kryetar.

Është një kërkesë e Grupit Parlamentar të AAK-së që mbështet kërkesën e deputetit Emrush Xhemajli që e ka kërkuar informatën për takimin në Vjenë. Grupi Parlamentar i AAK-së, duke marrë parasysh rëndësinë e këtyre bisedimeve ,konsideron se duhet të mbahet një seancë e veçantë ,në të cilën jo vetëm që të informohet Kuvendi, por edhe të raportojë ekipi i unitetit, përkatësisht Delegacioni i Kosovës që është në varësi të Kuvendit, për rrjedhat e bisedimeve në Vjenë. E di se është paraparë në agjendë informata për këto bisedime, por ne konsiderojmë se duhet të jetë një seancë e veçantë para 16, gjegjësisht 17 marsit ,kur është paraparë raundi i dytë i bisedimeve. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ju faleminderit Gjylnaze, besoj se edhe Emrush e ka të njëjtin shqetësim, sepse është paraqitur për fjalë. Kryesia e ka shqyrtuar kërkesën e LPK-së dhe ka vendosur që jo informatë po të vihet pikë e rendit të ditës . Është biseduar edhe më gjerë për këtë, por nuk dua të hyjë në detaje. Unë mendoj se edhe kërkesa juaj është në vazhden e kësaj. Pse është lënë për 16 mars seanca? Ne kemi propozuar në Kryesi të jetë me 9 mars, por për shkak të vonesës së komisioneve përkatëse për ligjet ka dominuar arsyeja që Kryesia ta pranonte. Do ta kemi mbledhjen e Kryesisë, siç i premtova në përgjigje edhe Jakup Krasniqi për programin e punës, mund ta shqyrtojmë dhe ta vendosim një datë, një ditë të veçantë, jo të jashtëzakonshme, por pune,por Emrush nuk ka nevojë për fjalë nëse e ka të njëjtin shqetësim.

Fjalën e ka z. Sabit Rrahmani, të përgatitet Teuta Sahatçia.

DEPUTETI SABIT RRAHMANI

Z. kryetar, jam Sabit Rrahmani, por pasi se kam kartelën time desha të paraqitem me kartelën e tij, por nuk prish punë, me siguri.

Z. kryetar, meqë në mëngjes kemi pasur një kërkesë të banorëve që janë në kampin e Mitrovicës, në pjesën Veriore të Mitrovicës, aty kanoset një rrezik nga epidemi të ndryshme që vazhdimisht kanë ndodhur gjatë këtyre ditëve. Kërkesë e pushtetit lokal të Mitrovicës dhe e institucioneve të ndërkombëtarëve është që ata ta lëshojnë kampin dhe të vendosen në kampin francez në fshatin Maxhunaj në komunën e Vushtrrisë. Kemi kërkuar takim, si delegacion i Komiteti të Ashkanlinjve, me kryeministrin. Kabineti qeveritar ka kërkuar prej nesh një propozim si mendojmë të zgjidhet kjo çështje. Por zgjidhja nuk mund të gjendet nga ne, por ajo duhet të gjendet nga Qeveria e Kosovës. Unë propozoj sepse Kuvendi nuk mundet me marrë vendim, propozoj që dikush nga Qeveria ose pikërisht kryeministri, në seancën e ardhshme të Kuvendit të Kosovës, të vijë këtu dhe të japë informacione se cilat janë platforma dhe formula e Qeverisë që ata njerëz të largohen nga kampi. Po ashtu ne jemi për t'u larguar nga kampi, por nuk jemi që të vendosen në kampin francez në fshatin Maxhunaj. Kërkesa jonë ka qenë që ata të vendosen në pjesën jugore të Mitrovicës në disa objekte të qëndrueshme që tash janë të zbrazëta, por jo në kampin e Vushtrrisë, sepse ka ndodhur në trazirat e marsit kur kemi qenë më 19 mars kur kemi qenë në vizitë te komuniteti Ashkanlinj në Vushtri, aty nuk janë aspak kushtet më të mira se në Plemetin. Mendoj se prej humnerës në humnerë do t'i qojmë, prandaj kërkoj që kryeministri i Kosovës, në seancën e ardhshme, të vijë dhe të raportojë se cila është platforma dhe programi i Qeverisë që t'i largojë njerëzit nga ai kamp. Për ne nuk ka mundësi t'i vizitojmë ata në kampin verior, meqë siguria është problem. Kemi kërkuar edhe nga Kuvendit komunal, por ata kërkuan që ne ta bënim një kërkesë në institucionet ndërkombëtare, pikërisht te KFOR-i, që e menaxhon atë kamp. Mendoj se komuna e Mitrovicës duhet ta marrë përsipër, se Mitrovicën e njohim si një - të pandarë. Kuvendi komunal i Mitrovicës duhet të bëjë më shumë për këta banorë. Unë mendoj kështu së paku. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ju faleminderit. Fjalën e ka Teuta Sahatçija, të përgatitet Emrush Xhemajli.

DEPUTETJA TEUTA SAHATÇIJA

Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë.

Pasi kolegu im, shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së e shprehi kërkesën e tij të vazhdueshme për përsheptimin e punës së Kuvendit dhe për çështje të tjera, ne në parim e mbështetim dhe mendojmë se është punë e mirë që Kuvendi do të jetë më dinamik dhe do të trajtojë çështje aktuale. Në parim, gjithashtu në përkrahim e përkrahim që të organizohet një seancë e veçantë për standardet, për dinamizmin e punës, për privatizim etj, prandaj e mbështesim plotësisht këtë kërkesë. Gjithashtu e mbështetim kërkesën e deputetit Berat Luzha, i cili për herë të dytë e hap çështjen e rrugës, e arteries shumë të rëndësishme që lidh Kosovën me Maqedoninë dhe që ka

rëndësi të veçantë për biznes dhe ne nuk duhet të na mjaftojnë vetëm shqetësimet tona dhe kërkesat tona, as pritjet e raporteve derisa në këtë kohë biznesi dhe ekonomia pësojnë goditje të rënda, prandaj propozoj që prej shqetësimeve, raporteve, nga një plogështi në trajtimin e kësaj çështje të kalojmë në një aksion a veprim në të cilin kërkohet të parashtrihen detyra dhe të kërkohet përgjegjësi, si është e mundshme që një rrugë e kësaj rëndësie të mos trajtohet në mënyrë çfarë duhet dhe të bllokohen biznesi, qarkullimi etj. Se këndejmi kërkoj që kjo të mos mbetet në shqetësime, të mos mbetet në pritje të pakufishme të raporteve, por të kërkohet zgjidhja.

Gjithashtu e përkrahim edhe kërkesën e z. Sabit Rrahmani për një zgjidhje të përgjithshme dhe jo të përkohshme, por jo bartjen prej një kampi në kampin tjetër dhe vazhdimin e agonisë së këtyre njerëzve. Përveç kësaj më 15 nuk pata rast të flisja edhe pse e kërkova fjalën, desha të flisja për çështjen e ngritur edhe herën e kaluar edhe tash të hotelit Union. E mbështesim gjithsesi kërkesën e artistëve edhe kërkesën e z. Jakup Krasniqi që kërkon të ketë qasje tjetër ndaj monumenteve, që ato të mos trajtohen si mall tregtie, ndërsa kërkesa e LDK-së po më habit pak, pasi që në bordin e AKM-së në atë bord që shet këto ndërmarrje, janë 2 ministra të koalicionit, atëherë shtrohet pyetja: A nuk kanë komunikim njëri me tjetrin apo për çka është fjala, ose mos është thjeshtë një aktrim i artistëve, para njerëzve të tjerë për ta treguar shqetësimin tonë? Mendoj se koalicioni qeverisës që i ka njerëzit aty nuk ka nevojë si OJQ apo në mënyrë teatrale të kërkojë këtu prej publikut mbrojtjen e monumenteve. I kanë ministrat, i kanë mjetet dhe le të zgjidhin aty ku duhet. Ne që nuk jemi në koalicion, mundem të kërkojmë publikisht nga televizioni e të shkruhet nëpër gazeta, por mendoj se nuk është serioze të kërkohet kjo në këtë mënyrë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Para se ta marrë Emrush fjalën për z. deputet një sqarim: Parlamenti me propozimin e ri për punë javore, po kthehet në traditën fillestare të vetën, për ata që nuk kanë qenë kurrë në Parlament, dy vjetet e parë ky parlament ka pasur seanca javore dhe e ka ndryshuar, prandaj mos hyni në ato çështje që nuk i dini fare.

Fjalën e ka Emrush Xhemajli, të përgatitet Ramë Buja.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI

Ju falënderoj z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë. I falënderoj Kryesinë që e ka marrë në konsideratë dhe Kuvendin që e ka përkrahur propozimin që e kam bërë për raportimin e Grupit për statusin e Kosovës në Kuvendin e Kosovës nga i cili është zgjedhur, gjithashtu edhe Grupin Parlamentar të AAK-së, në veçanti i mbështes të gjitha kërkesat që i bëri z. deputete Teuta Sahatçiu, për të mos i përsëritur, ndërkaq edhe një herë po them se nuk është në dobi vetëm të deputetëve të Kuvendit që ta dëgjojnë informatën për punën e Grupit për statusin deri më tash, por është në interes, do të thosha edhe të vetë grupit të punës, prandaj mendoj se data 17 që është caktuar që përsëri të ketë takime në Vjen na shtyn dhe na bind që duhet paraprakisht, d.m.th. pas një jave ose javën e ardhshme të mbahet një seancë, në mënyrë që grupit të punës t'i lihet mundësi që përsëri ta mundë palën serbe, siç po dëgjojmë që e ka mundur herën e kaluar. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Emrush ju faleminderit. Iu përgjigja Gjylnazes, por e njëjta përgjigje vlen edhe për ju, Fjalën e ka Ramë Buja, të përgatitet prof. Kuçi.

DEPUTETI RAMË BUJA

I nderuari z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë. Besoj se Parlamenti i Kosovës nuk është Parlament spektaklesh dhe nuk është diçka që gjërat t' i bëjmë vetëm për t' i kaluar dhe sa për të thënë një fjalë. Meqë kërkesa e deputetit të Partisë Demokratike ishte t' i krijonim qasje ose të jemi më serioz ndaj qasjes së problemit shumë të madh të mbylljes së rrugës qe 40 ditë, ta shkelim një procedurë të vogël. Pasi ministri është këtu dhe është më i informuari dhe më kompetenti për këtë çështje, të jap një informacion më të saktë dhe më përmbajtjesor këtij Kuvendi ,sepse ne po mbetemi në mjegull pasi informacionet që po i japin gazetatat herë me tendencë të caktuar e herë me tendencë tjetër. Çështja tjetër është , besoj që kërkesat e shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së, janë kërkesa edhe të grupeve të tjera parlamentare pse kjo çështje të mos hedhet në votë dhe të miratohet si kërkesë e tillë dhe gjithsesi të shkojë në procedura të tjera, andaj kjo është një kërkesë që besoj se do të duhej të kalonte, për faktin që ne e kemi trajtuar në Kryesi të Parlamentit në një temperaturë jo pak të ulët, por me gjithë atë ato nuk i ka dëgjuar opinionin dhe ne nuk jemi të informuar aq sa duhet se si është gjendja e tanishme e kësaj arterie kryesore të rrugës që për ne është shumë shqetësuese, andaj z. ministër, nëse pajtohet në këtë seancë dhe kryetari do të ishte mirë të na informonte. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ramë faleminderit dhe si koleg i Kryesisë përgjigjen ja dhashë shefit të Grupit Parlamentar. Nuk kam tjetër përgjigje, fjalën e ka profesor Kuçi i fundit dhe kalojmë në rend dite.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI

Faleminderit kryetar. Ne të PDK-së ,përafërsisht, mendojmë njëjtë dhe tërhiqem në dobi të asaj që e tha z. Ramë Buja.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ju faleminderit shumë.

Para se të kalojmë në rend dite, propozimet janë.

Pika e tretë: **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trashëgiminë kulturore**, është shkresa e kryeministrit dhe kërkohet të tërhiqet nga rendi i ditës i seancës së sotme që të plotësohet dhe përmirësohet cilësia.

Po ashtu pika shtatë e rendit të ditës: **Shqyrtimi i Projektligjit për ushqimin**, po ashtu, kërkohet nga Komisionet Funkcional t' i lihet kohë për përgatitje më të mirë, prandaj mendoj që seanca do t' i miratojë .

Urdhëroni për pikën e parë të rendit të ditës, fjalën e ka Nazim Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI

Faleminderit z. kryetar. Ne dje e kemi marrë transkriptin e seancës plenare të datës 19, 20 dhe vazhdimet të 14 dhe 15 shkurtit. Kryesisht transkripti është punuar mirë, por ndodh nganjëherë të përvidhen gabime dhe do të ishte mirë që ata që e bëjnë këtë punë të përpiqen t'i mënjanojnë, sepse është një dokumentacion që duhet të mbetet sa më i saktë dhe sa më i përpiktë. Në faqen 86, me rastin e debatimit të datës së UÇK-së apo çfarë ishte ajo, sepse saktësisht nuk po më kujtohet, e kam një reagim (timin) në të cilin sipas kësaj që është thënë këtu i humb kuptimi fjalisë dhe mendoj se krijohet konfuzion, kam thënë: Ne mund ta caktojmë një datë, se shumicën e votave i keni si Qeveri, e jo i kemi se ne nuk jemi pjesë e Qeverisë, pra mund të jetë gabim shtypi, do t'i lutja ata që merren me transkriptin, ta korrigjojnë, shumicën e votave i **keni**, e jo i **kemi**. Në faqen 121 te debati që kemi kërkuar ne si parti politike është rreshti i 12 në atë faqe, ku thuhet: **Ne e dimë se rastet më të këqija 20% i tërë asaj shume futen në xhepat e dikujt**, nuk kam thënë ashtu, por kam thënë: **në rastet më të mira 10% futen në xhepat e dikujt**, pra është një ndryshim thelbësor, nuk është rasti më i keq 20%, por rasti më i keq është 50%.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ju faleminderit. Ju lutem, duhet të verifikohet, por sa e di unë transkripti është çështje që regjistrohet, mirëpo në qoftë se konstatohet gjithmonë të përmirësohen gabimet, sepse nuk e besoj që në transkript, në procesverbal mund të përvidhen, është çështja e subjektivitetit, por në transkript siç është e regjistruar nuk mund të përmirësohet regjistrimi është çështje e teknologjisë.
Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Arsimin dhe aftësimin Profesional

Miratimi i tij në parim është bërë më 25.07.2005, komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente. Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore me Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport si komision funksional dhe raportues është bërë radhitja e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e P/L për arsimin dhe aftësimin profesional.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se P/L për arsimin dhe aftësimin profesional ka bazë juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për arsimin dhe aftësimin profesional dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve kanë vlerësuar se dispozitat e P/L për arsimin dhe aftësimin profesional dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet dhe rekomandimet e Komisionit funksional:

Amendamenti 1

Lus regjinë që të përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

Për 75

Kundër 2

Konsideroj se ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 2

Lus regjinë që të përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

Për 74

Kundër 2

Konsideroj se ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 3

Lus regjinë që të përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 74

Kundër 3

Konsideroj se ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 4

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

Për 75

Kundër 1

Konsideroj se ka kaluar amendamenti

Kam një kërkesë për ndihmesë, gjithsej janë 62 amendamente, janë të komisionit funksional , a pajtoheni që t'i votojmë dhe në fund e votojmë Ligjin, ju faleminderit shumë.

Regjia përgatitemi për t'i votuar të gjitha amendamentet e ngelura, fjalën e kërkon z. Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI

Z. kryetar, me respekt. Mendoj se punë jona është t'i kalojmë amendamentet një nga një dhe nuk mundemi kështu në mënyrë arbitrare t'i grumbullojmë të gjitha amendamentet dhe t'i fusim në një kosh, pra këto janë amendamente që kanë të bëjnë me çështje të ndryshme. Është e vërtetë që Komisioni e ka kryer punën e vet, por është e vërtetë që

nuk ka ndonjë kontest në aspektin e asaj pune që është kryer, mirëpo ekziston një parim themelor në këtë kuvend, që duhet të respektohet. Më vjen shumë keq ,por duhet të jemi të përqendruar në punën që e bëjmë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Besoj që nuk keni nevojë t'ju vijë keq, është e drejtë juaja, unë e pashë shumicën, prandaj seanca ka të drejtë të deklarohet. Nuk kërkoj asgjë, në pesë amendamentet asnjë deputet nuk kërkoi të plotësojë diçka ,ose as të kërkoi sqarime. Unë prapë po e pyes seancën kush është që në tërësi t'i votojmë amendamentet?
Fjalën e ka znj. Nekibe, na ndihmoni ju lutem.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI

Mendoj se paraprakisht Kuvendi duhet të marrë vendim të votohen në pako amendamentet , pastaj të votohen amendamentet.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Kështu mendova, d.m.th, kush është që në pako t'i votojmë amendamentet.

Ju faleminderit. Shumica absolute, megjithëatë a ka vota kundër? Të numërohen.
Kundër kanë votuar 12 deputetë, 87 janë për.
Prandaj ju lutem të shkojmë në votim si pako të amendamenteve të mbetura dhe votojmë tani.

Për 66

Kundër 8

Konsiderojmë se kalojnë amendamentet në tërësi.

Fjalën e kërkon Gani Koci,

DEPUTETI GANI KOCI

Jam i vetëdijshëm se Kuvendi mund të marrë vendime që janë të plotfuqishme, por sikur po futet një rregull e re i miratimit të projektligjeve në pako. Rregullorja e punës së Kuvendit e thotë qartë se të gjitha amendamentet votohen veç e veç dhe në tërësi në fund votohet tërë ligji, prandaj ju lutem ta respektojmë këtë, mund të zgjatemi pak në kohë, por më mirë të zgjasim në kohë, por të mos i thyejmë rregullat që i kemi miratuar vetë, ose nëse është e kundërta, atëherë ta bëjmë një propozim dhe ta ndryshojmë këtë rregull dhe të fusim një rregull të re edhe të kësaj mënyre të votimit, siç e bëmë pak më parë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Gani ju faleminderit. Lus regjinë të përgatitemi për votim të ligjit me amendamentet e miratuara.

Përgatitemi për të votuar. Votojmë tani.

Për 72

Kundër 6

Prandaj konsideroj se u miratua ligji në tërësi.

Kalojmë në pikën e radhës.

Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për trashëgiminë kulturore e hoqëm nga rendi i ditës.

Pika në vijim është:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 22. 4. 2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendi i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime me amendamente. Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, si Komision Funkcional dhe Raportues, janë radhitur rekomandimet dhe amendament në tekstin e Projektligjit për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës ka bazën juridike e ka në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës as amendamentet e propozuara, nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Fjalën e kërkon Hydajet Hyseni. Urdhëroni

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

Faleminderit z. kryetar. Është rregull që Komisioni Referues të paraqesë raport për shqyrtimin e dytë të Projektligjit. Edhe unë dua ta shfrytëzoj këtë të drejtë.

Të nderuar deputetë. Projektligjin për Institutin Gjyqësor të Kosovës po e shqyrtojmë me vonesë të konsiderueshme. Siç e dini Komisioni Legjislativ ka kërkuar dhe Kuvendi ka miratuar kohë shtesë për shqyrtimin dhe amendamentimin e këtij projektligji. Arsyet kryesore për këtë shtyrje ishin- nga njëra - mungesa e zgjidhjeve të qëndrueshme sistemore dhe e ligjeve themelore përkatëse, dukuri që po na ndjek vazhdimisht, kurse nga ana tjetër- dallimet e ndjeshme si midis partnerëve tanë ashtu edhe faktorëve të involvuar në përgatitjen e këtij projektligji dhe atyre që do ta zbatojnë atë. Ndon se këto pengesa nuk janë eliminuar tërësisht, Komisioni në konsultim dhe në bashkëpunim me partnerët që ndihmojnë atë i ka hyrë sërish shqyrtimit dhe amendamentimit të këtij

Projektligji duke u përpjekur që zgjidhjet t'i përshtat dhe t'i harmonizoj edhe me procesin e ndërtimit të konceptit dhe bazës ligjore të sistemit të ri të drejtësisë në Kosovë. Kemi qenë dhe jemi të vetëdijshëm se në kontekstin në të cilin ndodhemi do të jetë i pashmangshëm ndonjë lëshim a mospërputhje me zgjidhjet sistimore ose me ligjet që do të nxirren në të ardhmen, por. Megjithatë, duke pasur parasysh fazën ekstensive të legjislacionit tonë ,jemi përcaktuar për të mos pritur edhe më shumë për shkak të nevojës së pashmangshme për ta siguruar bazën ligjore të funksionimit të këtij segmenti tejet të rëndësishëm, të sistemit juridik në Kosovë.

Me shpresë se mospërputhjet eventuale do të mposhten në ecje e sipër ose do të korrigjohen me ligjet e ardhshme sistimore.

Në procesin e shqyrtimit dhe amendamentimit të këtij projektligji, pos një sërë takimesh me karakter pune, konsultimesh e informimi, Komisioni ka organizuar edhe një seancë dëgjimi publik që është vlerësuar e suksesshme dhe e dobishme. Rezultat i kësaj pune afatgjate ,Komisioni ka hartuar 22 amendamente ,që po ia paraqesim për shqyrtim Kuvendit. Amendamentet e propozuara janë fryt i bashkëpunimit, i koordinimit dhe i harmonizimit me Institutin Gjyqësor të Kosovës, me Këshillin Gjyqësor e Prokuroria të Kosovës, me Departamentin e Drejtësisë, me Departamentin e OSBE-së, me USAID-in si dhe me projektin e Agjencisë Evropiane për Mbështetje të Kuvendit.

Të nderuar kolegë deputetë, ju sugjerojmë që t'i mbështetni dhe miratoni amendamentet e propozuara, për ta lehtësuar shqyrtimin e rregullt dhe të shpejtë të amendamenteve, do të propozonim të grupohen dhe të votohen në përputhje me Rregulloren e punës së Kuvendit amendamentet që kanë të bëjnë me ndryshimin në nenin 2 të terminologjisë për bordin dhe për drejtorin. Mendoj se amendamentet e tjera ,për shkak të praktikave parlamentare dhe të rregullsisë, të votohen veç e veç. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Hydajet ju faleminderit. Merruni vesh me kolegun e grupit tuaj parlamentar, me Ganiun dhe ne po vazhdojmë një nga një kësaj radhe.

Amendamenti 1

Regjia të bëhet gati për vendimmarrje dhe votojmë tani:

Për 64

Kundër 1

Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 2

Për fjalë paraqitet përsëri Hydajet Hyseni. Urdhëro

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

Më duket se nuk u sqaruam kryetar, sepse me gjasë se parasysh nuk merret Rregullorja e Kuvendit.

Amendamenti 2, ndryshon nocionet: Në vend të bordit drejtues, “Këshilli drejtues” dhe në vend kryeshef ekzekutiv: “Drejtor i Institutit Gjyqësor”. Sipas Rregullores së Kuvendit amendamentet çdo kund në ligj ku është ky ndryshim mund të votohen nën një pako, sepse është fjala për të njëjtin ndryshim dhe s’ka nevojë të votohen të gjitha, mirëpo kjo nuk mund të vlejë për amendamente të tjera që janë përmbajtësish të ndryshme. Unë desha ta shfrytëzoja rastin pikërisht për të bërë këtë korrigjim, që besoj se na lehtëson dhe na parandalon të mos bëjmë një gabim dhe të vendosim praktika pa paprecedentë në shqyrtimin parlamentar. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Z. kryetar, unë nuk e kam obligim të punoj si të më thotë secili, e dyta unë ju dhashë fjalën si kryetar i Komisionit e jo të ma sqaroni mua dhe e treta, nuk e kam për detyrë se nuk jam jurist as avokat t’i ndaj nenet, prandaj nuk ka replikë dhe asgjë tjetër E shfrytëzuat të drejtën dy herë për të njëjtën çështje.

Regjia ju lutem, përgatitemi për të votuar për amendamentin nr. 2 ,siç e kanë deputetët të shkruar.

Amendamenti 2

Votojmë tani.

Për 66

Kundër 4

Amendamenti ka kaluar.

Amendamenti 3

Nuk ka sqarime dhe përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

Për 67

Kundër 2

Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 4

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 68

Kundër..... 1

Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 5

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 69

Kundër 1
Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 6

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 65
Kundër 3
Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 7

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 64
Kundër 3
Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 8

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 71
Kundër 1
Ka kaluar amendamenti

Amendamenti 9

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 67
Kundër 2
Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 10

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 64
Kundër 3
Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 11

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 60
Kundër..... 3
Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 12

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 65

Kundër 2

Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 13

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 63

Kundër 4

Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 14

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 66

Kundër 3

Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 15

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 64

Kundër 1

Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 16

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 68

Kundër 2

Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 17

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 68

Kundër 3

Ka kaluar amendamenti.

Para se ta votojmë në tërësi, ministrja Tërmkollli e ka fjalën.

MINISTRJA MELIHATE TËRMKOLLI

Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë. Unë paraprakisht kërkoj falje që nuk e kam vërejtur me kohë njërin nga këto amendamente që mendoj se duhet të rishqyrtohet edhe një herë. Është fjala për amendamentin e tretë që krijon një konfuzitet dhe parregullsi në përputhje me dispozitat aktuale ligjore në fuqi dhe i krijon një konfuzitet edhe funksionimit të mekanizmave që i zgjedh Parlamenti i Kosovës. Do të thotë këshillin drejtues e zgjedh drejtori i Institutit Gjyqësor nëpërmjet institucionit të konkursit, porse ky këshill drejtues përbëhet nga anëtarët që i zgjedh Parlamenti i Kosovës, kujtoj se këtu ka mospajtueshmëri ,sepse institucioni që e zgjedh Parlamenti ose grupi nuk ka asnjë mundësi që ky komision ose këshill drejtues të merret me një konkurs për një drejtorë çfarëdo qoftë. Drejtorët, veç nëse duhet të zgjidhen. Ma merr mendja se kjo duhet të hyjë njësoj në anëtarët që i propozon Parlamenti i Kosovës dhe në mesin e tyre të zgjidhet ai, përndryshe rregullat e konkursit parashohin mekanizma dhe rregulla të tjera të zgjedhjes. Është shumë e palogjikshme që ky komision apo ky grup të merret me një konkurs. Unë do të doja një sqarim nga të tjerët që janë më afërt me këtë çështje. Ju faleminderit, mund të krijoj probleme në praktikë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ju faleminderit, profesor Kuqi.

DEPUTETI HAJREDIN KUQI

Do ta ngrit një çështje që besoj se juristët do ta vërejnë,ngase gjatë implementimit të këtij ligji në praktikë do të ketë pasoja të mëdha. Këtu fjala është për një pasus nëse mund ta quaj kështu, që na përsëritet gati çdo kund, thuhet: “anëtarë të bordit janë kryetari i Këshillit Gjyqësor dhe Prokurrial të Kosovës ose trashëguesi i tij ligjor”-vazhdimisht përsëritet. Trashigues ligjor ,sipas sistemit juridik, mund të jenë gruaja e tij, djali, ose vajza ose dikush tjetër dhe mendoj se kjo duhet të hiqet dhe të thuhet: “I autorizuari i tij, përfaqësuesi ose diçka tjetër”, por jo trashëguesi. Sipas këtij neni trashëguesi lirisht mund të shkojë në gjyq e shoqja e tij, fëmijët e tij ose dikush tjetër. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Profesor dhe kryetar i Komisionit z. Hyseni, urdhëro Hydajet.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

Faleminderit z. kryetar, po të ma kishit dhënë fjalën kur e kërkoja, e kisha të drejtë dhe do t’ju kisha thënë edhe një herë faleminderit, por më lejoni që edhe vërejtjet që u bënë të na shërbejnë si një dëshmi se ne duhet t’i shqyrtojmë edhe nen për nen ligjet ,sepse ndryshe nuk do të kishim mundësi të ndalemi edhe në këto çështje. Lidhur me vërejtjen e parë, natyrisht e mirëpresim, por tërheqim vërejtjen se Qeveria dhe ministria përkatëse, në këtë rast edhe Ministria e Shërbimeve Publike, sepse institucioni gjyqësor i Kosovës

ka qenë i lidhur me Ministrinë, kanë qenë sponsor të ligjit ,e kanë pasur në dorë, kanë qenë pjesë e shqyrtimit të ligjit edhe në shqyrtimin e parë edhe gjatë amendamentimit, janë ftuar edhe në dëgjim publik. Kam përshtypjen se kjo vërejtje nuk është shtruar asnjëherë-, tërheq vërejtjen dhe dëshiroj që deputetët ta krahasojnë në nenin e parë, që është në pjesën e majtë të tekstit. Në tekstin fillestar ku thuhet tekstualisht: “Kryeshefin e Institutit Gjyqësor të Kosovës pas një konkursi publik, e emëron bordi drejtues i institutit etj, dhe gjithashtu bordi drejtues e mban të drejtën e shkarkimit të kryeshefit”. Komisioni ka ndryshuar vetëm nocionet në vend “kryeshef” dhe është parë bashkërisht e arsyeshme të quhet “drejtor” dhe në vend të “bordit” “këshill”. Prandaj mendoj se është vonë për vërejtje të tilla, por për më tepër është fjala për “kryeshefin ekzekutiv”.Edhe kryeshefi ekzekutiv ka qenë vlerësim i komisionit që do të ishte mirë të zgjidhet me konkurs, në mënyrë që t’u mundësohet të gjithëve e drejta për të konkurruar dhe në këtë ka pasur pëlqim të plotë edhe midis anëtarëve të Komisionit dhe përfaqësuesve të Zyrës Ligjore dhe partnerëve tanë, me të cilët kemi punuar. Mendoj se ne duhet ta miratojmë kështu siç është edhe nëse eventualisht shkakton probleme mund të iniciohet procedura e ndryshimit të ligjit.

Por lidhur me vërejtjen e dytë mund të jetë pasaktësi terminologjike, “trashëgues ligjor” me trashëgues institucional, por për të evituar çdo paqartësi fjala është për gjendjen aktuale, këshilli gjyqësor dhe prokurorial është një trup i përbashkët. Në sistemin e ardhshëm parashikohet të jetë një këshill gjyqësor dhe një këshill prokuroria. Kjo çështje ende nuk e ka marrë formën zyrtare ,d.m.th nuk është përfunduar, prandaj edhe është zgjedhur formulimi trashëguesit e tyre. Nëse shprehja ligjore mund të keqkuptohet, propozoj të zëvendësohet me shprehjen institucionale, d.m.th trashëguesit institucional, në këtë rast nëse është këshill prokurorial, është këshilli prokuror, nëse është këshilli gjyqësor dhe kjo mendoj se do të mund të kalohej dhe të mos e ngatërroj miratimin. Ju faleminderit.

KRYETRI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Hydajet, tepër vonë je me ligjërata sepse të mbahemi në profesione secili, merreni transkriptin dhe shikoni, jeni kundër vetvetes, krejt çka diskutoni 5 minuta më parë dhe 5 më vonë, prandaj vetëm seanca plenare mund ta anulojë vendimin. Sipas fjalimeve që po i mbani ju nuk është e mundur, ministrja ka të drejtë apo jo është me vonesë e paraqitur, sepse ne i miratuam, prandaj e vetmja mënyrë është që të amandamentohet në procedurën e mëtejshme, por në qoftë se seanca plenare e konsideron, me votim ka bërë gabim, është e drejtë e seancës.Unë nuk mund të vendosë për seancën. Numri i votave ka treguar që amendamenti ka kaluar si propozim i komisionit funksional dhe unë nuk e shoh asnjë mënyrë tjetër të dalim prej kësaj, pos ta votojmë në tërësi ligjin me amendamentet e aprovuara, në qoftë se shefat e grupeve parlamentare mendojnë që duhet përsëri të votojmë,për mua është në rregull.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI

Në amendamentin 5 është përdorur termi: “trashëguesit ligjorë”,në këtë rast kemi të bëjmë me persona juridikë, jo me persona fizikë, prandaj duhet të përdoret suksesori

juridik. Suksesor juridik është term i pranueshëm në drejtësi dhe i rregullon dhe i heq paqartësitë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Hydajeti don të replikojë, por me vonesë, ju lutem mos t'i komplikojmë gjërat.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

I nderuari dhe i pandërruari kryetar. Do të ishte mirë të ndërrojmë diçka nga praktikat tona, thashë dhe e kërkova fjalën për të bërë një sqarim, u përpoqa të bëj sqarim. Nëse eventualisht kjo ju ka tingëlluar si ligjëratë, ju siguroj se as nuk kam dëshirë, as nuk e praktikoj të mbaj ligjërata, madje mund të them se e konsideroj veten të durueshëm për të dëgjuar shpesh ligjërata edhe kur se kanë vendin. Megjithëkëtë më lejoni t'i abstrahoj të gjitha këto. Ende nuk e kemi miratuar ligjin në tërësi, kishte një vërejtje që të përmirësohej ligji. Është e vërtetë që është me vonesë, nëse konsiderohet se Kuvendi pajtohet që ne ta korrigjojmë këtë, mendoj që bëjmë një përmirësim dhe mundësi procedurale besoj se gjejmë, prandaj unë si anëtar i komisionit dhe përfaqësues i tij nuk shoh ndonjë pengesë që trashëguesi ligjor siç u tha juridik që është e njëjta gjë në fakt të zëvendësohet me njërin prej tyre ose eventualisht me atë që e thash unë do të ishte më adekuate, "Trashëguesi institucional" do të thotë trashëguesi institucional, ai që e trashëgon.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Hydajet replika nuk zgjat aq, të lutem dhe unë thash në qoftë se seanca plenare e sheh të arsyeshme, d.m.th shefat e grupeve parlamentare, ndërhyrje (urdhëro profesor kuqi edhe njëherë).

DEPUTETI HAJREDIN KUQI

Faleminderit z. kryetar. Mendoj se propozimi im nuk është propozim që duhet të vihet në votë ose jo, është propozim tejet profesional ,po e quaj kështu, të cilin do ta shqyrtojë administrata. Jam i gatshëm që ta jap kontributin tim, por po e them se në botën moderne, trashëgimia shkon me testament dhe me ligj edhe për personat fizikë dhe për ata juridikë. Në kuptimin e saj në administratë mund ta bëjmë një debat herën tjetër, pra le të mbetet siç është mënyra profesionale e jo politika e vendimmartjes. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Mendoj se mund të dalim ,sepse gjatë redaktimit ose lektorimit ajo që është profesionale-seanca- do ta respektojë dhe do të korrigjohet ajo që është brenda mundësive, për të mos u kthyer përsëri prapa.

Prandaj lus regjin që ta votojmë ligjin në tërësi me këto që u thanë dhe ku ka mundësi të përmirësohet.

Bëhemi gati ta miratojmë ligjin me amendamentet e miratuara dhe votojmë tani:

Për74

Kundër 3

Konsideroj se e kemi miratuar Ligjin me të gjitha amendamentet e miratuara.

Pika e radhës është:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kujdesin shëndetësor emergjent

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 3. 10. 2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime të tyre.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale , si komision funksional dhe raportues janë paraqitur rekomandimet si vijon.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për kujdesin shëndetësor emergjent ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për kujdesin shëndetësor emergjent dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për kujdesin shëndetësor emergjent dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet dhe rekomandimet e komisionit funksional:

Amendamenti 1

Nuk ka komente dhe përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 71

Kundër 3

Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 2

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 72

Kundër 2

Konsideroj se ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 3

(Ndërhyrje e Ferid Aganit, urdhëroni Ferid)

DEPUTETI FERID AGANI

Ju faleminderit z. kryetar. Mendoj se pjesa e parë e këtij amendamenti nuk duhet të miratohet, por të mbetet teksti siç është në tekstin ligjor të propozuar, ndërsa pjesa e dytë është në rregull. Ajo mund të hiqet nënpika (n). Arsyetimi është se në amendament gjendet se emergjenca mjekësore është definuar si lëndim trupore me simptome akute dhe me këtë rast janë përjashtuar të gjitha gjendjet e tjera mjekësore që do të thotë se janë të lidhura me sistemet tjera të organeve dhe mendoj se kjo ka mund të jetë edhe lëshim teknik i komisionit funksional, por mendoj se kjo pjesë e amendamentit nuk duhet të miratohet.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Mendoj që ka shumë logjikë, por kryetarja e Komisionit e ka fjalën, urdhëroni.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU

Personalisht e përkrah z. Ferid dhe mendoj se është lëshim teknik, sepse me të vërtetë gjendje akute janë të gjitha gjendjet tjera dhe plus lëndimet trupore.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ju faleminderit dhe përgatitemi për ta miratuar amendamentin ,siç e propozoi Ferid Agani.

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për..... 71

Kundër 2

Konsideroj se amendamenti u miratua me ndryshimin e theksuar.

Amendamenti 4

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 73

Kundër 0

Konsideroj se ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 5

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 74

Kundër 1
Konsideroj se ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 6

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

Për 77
Kundër 2
Konsideroj se ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 7

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 75
Kundër 0
Konsideroj se ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 8

Përgatitemi për votimi dhe votojmë tani:

Për 74
Kundër 3
Konsideroj se ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 9

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 73
Kundër 1
Konsideroj se ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 10

(Fjalën për amendamentin e 10 e ka kryetarja e Komisionit)

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU

Ju lutem një përmirësim të vogël në pikën (a) në amendamentin e 10 ku është: “Departamenti Universitar i emergjencave mjekësore” e jo siç shkruan: “Departamenti i emergjencave universitare” nëse ka mundësi të pranohet ky përmirësim teknik.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Besoj se kur e thonë profesionistët, ne të tjerët nuk kemi arsye ta kundërshtojmë

Përgatitemi për ta votuar me ndryshimin e radhitjes, siç u tha dhe votojmë tani

Për 73

Kundër 2

Konsideroj se ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 11

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

Për 71

Kundër 2

Konsideroj se ka kaluar amendamenti.

Në sallë janë të pranishëm 87 deputetë, ju ftoj që ta votojmë ligjin në tërësi me amendamentet e miratuara.

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 80

Kundër 2

Prandaj konsideroj se e miratuar Ligjin me amendamentet e miratuara.

Pika e radhës është:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për markat tregtare

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 5. 10. 2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte dhe rekomandimet të tyre.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, janë paraqitur rekomandimet dhe amendamentet.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për markat tregtare, bazën juridike e ka në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për markat tregtare dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe për Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e projektligjit për markat tregtare dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet dhe rekomandimet e komisionit funksional:

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI

Amendamenti 1

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për..... 64

Kundër 1

Konstatohet se ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 2

(Fjalën e ka kryetari i Komisionit)

DEPUTETI FATMIR REXHEPI

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë. Më intereson një shpjegim plotësues nga Komisioni që e ka propozuar këtë amendament, se thuhet: “të fshihet përmbajtja e Projektligjit”, si është në ligjet e tjera, a kemi edhe në ligje të tjera kësi amendamenti, në mënyrë që të mos dallohet nga ata. Në qoftë se kemi edhe në ligjet e tjera që i kemi miratuar diçka të ngjashme me këtë, është mirë të mbetet, por nëse nuk kemi pajtohem të hiqet përmbajtja e projektligjit, prandaj lus për një shpjegim shtesë nga ana Komisionit. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI

z. Hydajet a keni diçka të shtoni.?

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

Vërejtjen mund ta gjeni edhe në pjesën e bashkangjitur të raportit. Siç e dini, Komisioni për Çështje Legjislative i shqyrton projektligjet nga aspekti i ligjshmërisë, i kushtetutshmërisë dhe metodologjisë ligjvënëse, prandaj Komisioni ka konsideruar se fakti që ky ligj ka pasur përmbajtje si një formë që nuk e kanë ligjet e tjera që nuk është standarde me metodologjinë tonë ligjvënëse, nuk është e nevojshme dhe si të tillë ka sugjeruar që të hiqet edhe unë mendoj se duhet të hiqet.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI

Kryetari i Komisionit e ka fjalën edhe një herë.

DEPUTETI FATMIR REXHEPI

Mendoj që Projektligji nuk duhet të miratohet pa përmbajtje se nuk ka kuptim, mund të jetë neni që mund të riformulohet ose të duket më ndryshe, porse riformulimi duhet të jetë shumë konkret nga komisioni që e ka propozuar, përndryshe nëse thuhet projektligjin e aprovojmë pa përmbajtje kjo nuk ka kurrfarë kuptimi, prandaj them që nuk shkojnë këto të dyja, logjikisht është e papranueshme, prandaj hiqet ligji krejt, neni të korrigjohet nëse duhet, por kjo, siç është bërë prej Komisionit unë besoj se nuk ka kuptim as juridikisht.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit në sqarime dhe e vë në votim amendamentin 2.

(Ndërhyrje, fjalën e ka znj. Nekibe Kelmendi)

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI

Amendamenti 2 është i paqartë: “Të fshihet përmbajtja e ligjit”, pa u bërë konkret neni i ligjit, pjesë e ligjit, kapitull i ligjit, çka duhet të fshihet.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI

Z. Hydajet a bën ta jepni edhe një shpjegim për këtë amendament.?

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

Unë thashë se sqarimi i është bashkangjitur në pjesën e dokumentit që e ka secili deputet përpara. Mund të mos jetë e nevojshme ta them ,sepse unë nuk kam qenë në atë mbledhje kur është bërë rekomandimi, e sqarova se fjala është për një kërkesë që në përputhje me praktikën e respektimit të metodologjisë unike të ligjvënies, që neni që e ka futur përmbajtjen të hiqet fshihet si e panevojshme dhe jo në përputhje me metodologjinë e deritashme të ligjvënies. Sqarimet eventuale mund t’i jap nënkryetari i Komisionit që edhe e ka nënshkruar raportin. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI

Fjalën e ka Ramadan Kelmendi

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI

Duke qenë anëtar i këtij komisioni vlerësoj pikërisht këtë rast se ka të bëjë me gabim teknik, sepse duhet të jetë:” Të fshihet përmbajtja e nenit 2 të Ligjit”, çdo gjë është e qartë dhe asgjë nuk e komplikon.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI

Fjalën e ka kërkuar znj. Nekibe Kelmendi

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI

Nëse është fjala që të fshihet fjala “përmbajtja”, atëherë të futet në thojza fjala “përmbajtja” e jo përmbajtja e Ligjit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI

Fjalën e ka z. Fatmir Rexhepi

DEPUTETI FATMIR REXHEPI

Unë në dy paraqitjet e dëgjova z. Hydajet që thoshte i keni letrat përpara dhe në letra shkruan diçka si sqarim, unë mendoj se edhe ato letra që i kemi në vazhdim edhe kjo në amendament nuk ndryshojnë, janë të njëjta. Në rekomandimet që i jep komisioni thuhet: “Komisioni vlerëson se përmbajtja e Projektligjit duhet të fshihet dhe propozon këtë amendament: Të fshihet përmbajtja e projektligjit” kjo nuk do ta ketë asnjë ndryshim me këtë që e kanë dhënë në faqen e parë, prandaj sërish po them ose Hydajeti nuk e ka lexuar ose nuk është në dijeni fare se çka ka bërë me këto letra komisioni i tij, prandaj vetëm kërkoja shpjegim, nuk kam asgjë të keqe, por kjo që është bërë nuk ka kuptim. Në projektligj e di si është, por ne kemi bërë amendamente, sepse e kemi vlerësuar se duhet të bëhen. Meqë është amendament i tyre edhe tash po e interpretojnë gabimisht. E di çka duhet të bëjmë, por le të urdhërojnë ata që e kanë bërë.

KRYESUESI GAZMENT MUHAXHERI

Për fjalë është paraqitur Naim Jerliu

DEPUTETI NAIM JERLIU

Ju faleminderit z. kryesues. Është e vërtetë se është gabim propozimi i amendamentit që e ka bërë Komisioni për Çështje Legjislative, por nëse i hidhet një shikim Projektligjit bëhet e qartë se fjala është për një kapitull të tërë, që është pjesa e parë e Projektligjit, dispozitat e përgjithshme dhe pjesa e dytë ku numërohen: Kreu I, Kreu II, Kreu III vazhdimisht si tituj që në fakt brenda në projektligj janë trajtuar. Kjo është njëfarë liste hyrëse e neneve që trajtohen në projektligj. Ata sigurisht e kanë konsideruar se do ta largonin këtë si diçka të tepërt edhe nëse hiqet ose nuk hiqet asgjë nuk ndryshon në përmbajtjen konkrete të ligjit.

KRYESUESI GAZMENT MUHAXHERI

Fjalën e ka ministri i Tregtisë dhe Industrisë z. Bujar Dugolli

MINISTRI BUJAR DUGOLLI

Ne normalisht e kemi ndjekur një praktikë sikur që kemi dërguar çdo herë ligje në Parlament, që secili ligj ta ketë përmbajtjen në fillim. Unë mendoj se ka bazën kushtetuese dhe ligjore, po ashtu e mbështeti propozimin në komisionit funksional se amendamenti 2 është i paqartë dhe nëse bëhet fjalë për përmbajtje në ndonjë nen është

diçka tjetër, por pasi është i paqartë propozoj të mos votohet amendamenti 2 dhe të votohen amendamentet e tjera të komisionit funksional. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMENT MUHAXHERI

Ju faleminderit z. Ministër, Fjalën e ka kërkuar Bajrush Xhemajli

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI

Unë mendoj se ky amendament duhet të hiqet dhe të procedohet siç është proceduar deri më tash edhe në shqyrtimin e projektligjeve që i kemi bërë, mendoj se komisioni funksional ka pasur të drejtë që e ka lënë ashtu siç është e jo Komisioni Legjislativ. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMENT MUHAXHERI

Në fund fjalën e ka kërkuar z. Kolë Berisha

DEPUTETI KOLË BERISHA

Ky amendament ka të bëjë me fjalën “përmbajtje”, në qoftë se mendohet në përmbajtjen e ligjit, d.m.th. të krejt tekstit, nuk vjen në këtë pjesë ku është tash, duhet ose në fillim të ligjit ose në fund, sepse në ligje nuk praktikohet kjo, d.m.th. fjala “përmbajtje” duhet të hiqet dhe mbetet pjesa e parë: “dispozitat e përgjithshme”.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit. Ju lutem amendamentin 2 nuk e votojmë dhe kalojmë në amendamentin 3.

(Polemikë)

Atëherë le të merren vesh dy kryetarët e komisionit dhe vendosim për amendamentin 2, në bazë të propozimit të këtyre dyve.

Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI

Të jepet një pauzë dhe komisionet le të merren vesh se çka do të ndodh me këtë amendament, pra çka është kjo fjalë “përmbajtja” a është përmbajtja e krejt tekstit apo përmbajtja në fund të tekstit të ligjit që është një faqe e shtuar që e përshkruan

përmbajtjen e ligjit, të merren vesh se çka është kjo sepse duhet të votohet për amendamentin patjetër.

KRYESUESI GAZMEND MUHAGJERI

Fjalën e kërkon edhe një herë Kolë Berisha

DEPUTETI KOLË BERISHA

Nuk bëhet fjalë për përmbajtjen e ligjit, por për një fjalë të shkruar “përmbajtja” d.m.th te pjesa e parë, bëhet fjalë vetëm për fshirjen e fjalës “përmbajtje”, kjo do të thotë fshihet.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI

Atëherë po e japim një pauzë 15- minutshe dhe le të dakordohen kryetarët e komisioneve funksional dhe legjislativ dhe pastaj e votojmë.

Atëherë le të jetë pauza e drekës 1 orë e gjysmë dhe pas kësaj e vazhdojmë seancën.

Vazhdimi i seancës pas pauze më 23. 2. 2006 në orën 13

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI

E ka fjalën kryetari i Komisionit z. Hydajet Hyseni, të bëjë sqarime.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

Faleminderit z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë.

Në pauzën që kishim e sqaruar një çështje që duhej të ishte e qartë që në fillim. Është fjala për një lëshim teknik që është thjeshtë punë e teknikës administrative.

Komisioni Legjislativ i ka dërguar Komisionit rekomandimet e tij, muaj më parë. Ka pasur kohë që rekomandimi i Komisionit ,sipas obligimeve të Rregullores të shqyrtohej dhe ky lëshim eventualisht të tejkalohet më parë dhe të mos vinte në seancë. Po e them këtë edhe si një sugjerim për komisione që t'i shqyrtojnë edhe amendamentet e komisioneve të tjera.

Fjala është ,siç u tha edhe në fillim, për një lëshim në teknikën e ligjvënies , do të thotë për metodologjinë e ligjvënës që duhet të jetë unike. Në ligjin që kemi përpara është futur pjesa- përmbajtja e ligjit- që jo vetëm që është në shkresën përcjellëse,por është edhe pas preambulës së zakonshme të ligjit- as nuk është pjesë e preambulës as nuk është nen në vete, por është diçka që nuk qëndron në praktikën tonë legjislative. Prandaj. propozimi ynë i riformuluar, e çmojmë vërejtjen që është bërë, sepse vërtet nuk ishte e saktë ashtu siç është formuluar, të riformulohet tash në këtë mënyrë.

“Pas preambulës së Projektligjit fshihet tërë teksti me emërtimin përmbajtja deri te pjesa e parë- dispozita të përgjithshme.Do të thotë ,pjesa që përfshin përmbajtjen e ligjit, të fshihet si e panevojshme dhe e pazakonshme për aplikim parlamentar”. Faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI

Ju faleminderit.

Përgatitemi për votimin e amendamentit sipas propozimit të kryetarit të Komisionit. E ka fjalën kryetari i Komisionit FunkSIONAL.

DEPUTETI FATMIR REXHEPI

Sa i përket propozimit të ri nuk prish punë , është në pajtim me ato kushte me të cilat hartohet projektligji .Por kam kundërshtimin tim lidhur me paraqitjen e z. Hydajet .Sipas tij, komisionet e tjera parlamentare nuk i shqyrtojnë projekt amendamentet, siç u cek këtu.

Them se Komisioni që e drejtoj as që e ka pasur këtë në rend dite. Ka ardhur me vonesë ose jo, është punë e tyre. Këtu është një projekt që e kemi para vetës, përndryshe ne të gjitha punët i kemi kryer me kohë dhe si duhet. Pra vlerësimi i tillë nuk qëndron . Nuk është kjo krejt çështje teknike as e teknikës me vlerësimin tjetër, por vërtet ka qenë çështje përmbajtjesore. Tash është korrigjuar dhe mund të shkojë. Faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI

E ka fjalën Hydajet Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

Ju lutem vetëm sa për të mos lënë paqartësi. Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar ligjin më 9.11, kurse Komisioni për Çështje Legjislative e ka shqyrtuar më 17 tetor. Sipas rregullit dhe procedurës sonë një komision që vlerësohet si referues funksional, siç e kemi thënë, duhet t'i shqyrtojë edhe rekomandimet e amendamentet e komisioneve të tjera,kështu që kjo do ta lehtësonte punën e Kuvendit dhe do ta evitonte situatën që është krijuar. Po e përsëris, vërejtjen e konsideroj me vend dhe e çmoj. Faleminderit.

KRYETARI NEXHAT DACI

Regjia: përgatitemi për të votuar. Sipas sqarimeve që janë dhënë në formë të shkruar. Votojmë tani:

Për	66;
Kundër	5.

Ka kaluar amendamenti me sqarimet e plotësimet e theksuara.

Amendamenti 3

Përgatitemi për të votuar, dhe votojmë tani:

Për	70;
Kundër	3.

Ka kaluar amendamenti 3.

Amendamenti 4

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për	72;
Kundër	3.

Ka kaluar amendamenti 4.

Amendamenti 5

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për	71;
Kundër	2.

Ka kaluar amendamenti 5.

Amendamenti 6

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për	73;
Kundër	2.

Ka kaluar amendamenti 6.

Amendamenti 7

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për	70;
Kundër	4.

Ka kaluar amendamenti 7.

Amendamenti 8

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për	70;
Kundër	3.

Ka kaluar amendamenti 8.

Amendamenti 9

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për	73;
Kundër	2.

Ka kaluar amendamenti 9.

Amendamenti 10

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për	76;
Kundër	3.

Ka kaluar amendamenti 10.

Amendamenti 11

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për	68;
Kundër	1.

Ka kaluar amendamenti 11.

Amendamenti 12

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për	72;
Kundër	3.

Ka kaluar amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Përgatitemi për votim votojmë tani:

Për	74;
Kundër	5.

Ka kaluar amendamenti 13.

Amendamenti 14

Përgatitemi për vendimmarrje dhe votojmë tani:

Për	73;
Kundër	3.

Ka kaluar amendamenti 14.

Amendamenti 15

Përgatitemi për votim votojmë tani:

Për	71;
Kundër	1.

Ka kaluar amendamenti 15.

Amendamenti 16

Përgatitemi për votim votojmë tani:

Për	73;
Kundër	3.

Ka kaluar amendamenti 16.

Amendamenti 17

Përgatitemi për votim dhe tani votojmë:

Për	68;
Kundër	3.

Ka kaluar amendamenti 17.

Amendamenti 18

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për	69
Kundër	3.

Ka kaluar amendamenti 18.

Kam një mendim, meqë janë të Komisionit FunkSIONAL 15 amendamente, asnjë mendim tjetër në debat .A jemi të mendimit ta pyes kryetarin e Komisionit FunkSIONAL çfarë mendon që t'i votojmë këto 18 të tjerat , sa kanë mbetur në pako. Vetëm Ganin s'po e pyes.

DEPUTETI FATMIR REXHEPI

E kemi ndërruar kësaj radhe, kryetari këndeje është. Z. kryetar jemi dakord edhe ashtu kemi bërë një debat më herët, kështu që propozimi është në rregull.

KRYETARI NEXHAT DACI

Prandaj mendoj, s'është askush kundër. E pyes regjin të bëhet gati për t'i votuar amendamentet e mbetura në pako.

Përgatitemi për votim, dhe votojmë tani:
85 deputetë janë të pranishëm në sall.

Për	63;
Kundër	15.

Prandaj konsideroj se i miratuar edhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional. Lus regjinë të bëhet gati të votojmë për ligjin në tërësi me amendamentet e miratuara.

Bëhemi gati për votim, dhe votojmë tani:

Për	76;
Kundër	5.

Konsideroj që e kemi miratuar Ligjin që është shqyrtuar me amendamentet e propozuara.

Kalojmë në pikën e radhës.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat e pjesëtarëve të Luftës së UÇK-së, të familjeve të dëshmorëve dhe të viktimave civile të luftës

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 26.1.2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime me amendamentet e caktuara. Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision Funkcional dhe Raportues është bërë radhitja e rekomandimeve dhe e amendamenteve në tekstin e Projektligjit për të drejtat e pjesëtarëve të Luftës së UÇK-së, të familjeve të dëshmorëve dhe të viktimave civile të luftës.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për të drejtat e pjesëtarëve të Luftës së UÇK-së, të familjeve të dëshmorëve dhe të viktimave civile të luftës ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për të drejtat e pjesëtarëve të Luftës së UÇK-së, të familjeve të dëshmorëve dhe të viktimave civile të luftës dhe amendamentet e propozuara përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni e miraton Projektligjin në parim dhe i rekomandon Qeverisë së Kosovës që zbatimit të tij t'i qaset kur të krijohen kushtet dhe mundësitë buxhetore të buxhetit të Kosovës.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për të drejtat e pjesëtarëve të Luftës së UÇK-së, të familjeve të dëshmorëve dhe të viktimave civile të luftës dhe se amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat e interesat e komuniteteve.

Amendamentet dhe rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 1

Urdhëro Flora.

DEPUTETJA FLORA BROVINA

Gjatë shqyrtimit në Komision kemi pasur betimin, të mos them garancinë e ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, se ky ligj ka buxhet dhe mund të vazhdojë menjëherë posa të miratohet. Kemi bërë një punë shumë të madhe, sepse ligji është prej fillimit gati. Është përpunuar në bazë të diskutimeve që janë dhënë këtu dhe vërejtjeve që kanë dhënë grupet parlamentare, pra dua ta dëgjoj fjalën e ministrit se ku është buxheti? Ky formulim që ka dhënë Komisioni për Buxhet është diçka që e shtyn shumë një çështje që e kemi shtyrë dhe duhet të na vij turp për këtë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Naser, jam në rrjedhë dhe do ta japë fjalën.

Mendoj se në këtë ligj nuk ka nevojë të futemi në debat, në vërejtje, në ofendime. Është një ligj që shumë kohë ishte në procedurë, madje nga mandati i kaluar i përbërjes së Kuvendit. Çështje të tjera mendoj që sot duhet të jenë anësore. Duhet të funksionojmë sipas propozimeve që i kemi dhe do të bëjmë maksimumin e mundshëm si Kuvend, si Qeveri, si institucione, që të aplikohet mundësisht sa më parë. Naser, urdhëroni, por pa tensionime. Urdhëroni.

DEPUTETI NASER OSMANI

Faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë.

Është ky ligj që na ka djersitur mirë dhe kemi pasur qasje shumë korrekte me anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe kemi theksuar në njërin anë atë që ky ligj ka implikime të jashtëzakonshme buxhetore. Kostoja e zbatimit në praktikë të këtij ligji është më se 80 milion euro, por po të kihet parasysh se pjesa dërmuese e ligjit vetëm

zbatohet, nevojiten diku mbi 14 milion euro për t' u zbatuar në tërësi. Duke pasur parasysh kornizën afatmesme buxhetore që del në vitin 2008, buxheti i Kosovës. Sivjet nuk do të ketë mundësi të rritet .Sipas asaj që dimë deri më sot, kemi konstatuar se ky ligji deri në këtë vit nuk mund të gjejë zbatim në praktikë. Prandaj kemi sugjeruar se Qeveria në momentin kur i siguron mjetet e veta ,duhet ta zbatojë këtë ligj. Kam vërejtur këtu edhe një gabim teknik që duhet ta përmirësojmë, për arsye se ne nuk mund t'i rekomandojmë, por duhet ta nxjerrim si amendament dhe atë në dispozitat përfundimtare të këtij ligji që kjo që figuron në faqen e parë vetëm të bartet dhe me këtë ligji gjen zbatim dhe mund të përcaktohem për vitin 2009 prej fillimit të vitit. (Polemikë).

Mirëpo konstatimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa është që ky rekomandim vetëm bartet në amendamentin 20, te dispozitat kalimtare. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Nuk do të hap debat. Edhe një herë dëgjoni me vëmendje, ju lutem.

Unë mendoj që Komisioni për Buxhet e Financa dhe të gjithë ata e kanë kryer punën e vet profesionalisht, ekonomikisht, financiarisht nuk kemi vërejtje. Ligji që është në rend dite i tejkalon këto. Ne do t'i ndihmojmë Qeverisë në çdo masë plotësuese që do t'ia propozojmë Kuvendit, që për një kohë sa më të shkurtër, të krijojmë kushte .Ju lutem, kur të flas unë, të më dëgjoni, sikur unë që po ju dëgjoj juve gjithmonë. Nuk jeni kryetare e Komisionit, prandaj mos ndërhyjni, sepse me këto ndërhyrje tre vjet, gati tre vjet e kemi shtyrë miratimin e këtij ligji. Prandaj po ju them ta miratojmë ligjin sipas procedurës që ka arritur në Parlament. Debate të tjera, rrugë të tjera bashkërisht Qeveria me Parlamentin të përpiqemi. Nuk mund ta akuzojmë Qeverinë , sot nuk mundet. Por ka vend që këtu ta shqyrtojmë, se që tre vjet e kemi në dorë, vetëm Nait Hasani edhe s'ka. Urdhëro Nait.

DEPUTETI NAIT HASANI

I nderuari kryetar, të nderuar ministra të nderuar deputetë.

E përshëndes këtë ligj që ka ardhur. Sot po miratojmë Ligjin për familjet e dëshmorëve,të veteranëve, e të invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që është me rëndësi të veçantë që ne si Kuvend i Kosovës eta shqyrtojmë në leximin e dytë këtë ligj. Dhe ne duhet ta miratojmë këtë ligj, që edhe atyre familjeve të dëshmorëve,të veteranëve e të invalidëve të UÇK-së t'u ndihmojmë , së paku si institucion, në mbrojtjen e tyre, për mundin, sakrificën , gjakun e derdhur për Kosovë e atdheun. T'u japim vend të merituar në shoqërinë e Kosovës, sepse ata meritojnë më shumë se kaq, por për fillim dhe në rrethana që po kalon Kosova nuk është e mjaftueshme, por e mirëseardhur për këtë kategori shoqërore te ne. Por, me gjithë të mirat e këtij ligji, për këto kategori shoqërore, Ligji nuk është i përkryer, por është më i miri, ndoshta tash për tash.

Po ky ligj ka edhe mangësi , që mendoj ,por edhe jam përgjegjës t'jua them se nuk duhet të anashkalohen. Këto mangësi nuk janë shumë, por e them me bindje e

ndërgjegje dhe jam më kompetent se të gjithë këtu në sallë për këtë, se nuk ka nevojë të trajtohet në kohë e mëhershme për dëshmorët, ngase nuk ka pasur të rënë nga struktura e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës para datës 31 janar 1997.

Ndonëse Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte formuar dhe strukturuar, ajo për vite nuk kishte humbje nga radhët e saj deri më 1997. Dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duhet të trajtohen nga dëshmori i parë më 31 janar 1997 deri te dëshmori i fundit më 20 qershor 1999, që nënkupton nga rënia e parë deri në përfundim të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Po sipas këtij parimi duhet të trajtohen edhe veteranët që nga themelimi i UÇK-së deri në përfundimin e luftës, sepse në Kosovë kemi pasur lëvizje ilegale në kolizion kohor nga 1913- kur Kosova është shkëputur nga trangu i saj-Shqipëria, në veçanti demonstratat e vitit 81 bën që në Kosovë të udhëhiqet koncepti i mirëfilltë i çlirimit të saj nga pushtimi kolonial serb. Të gjitha këto përpjekje të brezave të tërë në historinë e Kosovës ,që udhëhoqën lëvizjet ilegale në Kosovë, më se miri u sublimuan me themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në vitin 1994. Për këtë në mbledhjen e mbajtur më 17 nëntor 1994,themelohen Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Shtabi Qendror i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nëpërmjet komunikatës numër 11 merr përgjegjësinë për aksione e kryera kundër forcave pushtuese koloniale serbe në territorin e Kosovës. Ky ligj ,që po e miratojmë sot me amendamentin 4 të nenit 2, në paragrafin e 1 pika 1, duhet ta përkufizojë qartë e saktë se dëshmori i UÇK-së është ushtari që ka rënë nga 31 janari 1997 deri më 20 qershor 1999. Është i pakuptimtë paragrafi 1 pika 1 se prej 31 dhjetorit 91 është dëshmor i UÇK-së deri më 19 shtator 1999.

Po ashtu edhe në nenin 6, amendamenti 4 i këtij ligji në pikën 6.1. ku thuhet se veterani i Luftës së UÇK-së është luftëtari i angazhuar në UÇK prej 30 dhjetorit 1991 deri dy javë pas nxjerrjes së urdhrin për mobilizim të përgjithshëm nga Shtabit i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të datës 1 prill 1999.

Mendoj dhe them se kjo nuk është e saktë, sepse nuk ka pasur mundësi me pas veteranë të UÇK-së sepse nuk ka pasur Ushtri Çlirimtare të Kosovës në atë kohë. Prandaj, ju kolegë të nderuar deputetë, mund të mos pajtoheni me mua me këtë që po e them, por më tregoni njëri nga ju ,këtu që jeni në sallë, kur e keni dëgjuar për herë të parë fjalën UÇK- (Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës). Po e them, me komunikatën e parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës numër 11 të datës 17 nëntor 1994. Dhe para se të miratohet ky ligj për këto kategori shoqërore kërkoj të bëhen përmirësimet që i theksova më lartë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Nait, ju dhashë fjalën, ju dëgjova për do respekte të tjera, tash i kemi amendamentet. Pak t'i qartësojmë një herë. Në qoftë se pranohet që ky komision funksional ka bërë punë shumë të madhe dhe kohë shumë të gjatë, dhe shumë konsultime të hershme të niveleve të ndryshme. Në qoftë se qëllimi i seancës është që t'i kemi ligjin dhe amendamentet kur të vijë profesionistë të propozojmë ,kurse seanca e miraton të hyjmë të krijojmë mbresë, sepse një diskutim e kërkon tjetrin. Kemi kohë sa të doni- 3 vjet e

shtymë, mund ta shtymë edhe 6 të tjera, por ju lus të hyjmë në procedurë miratimi..
Jakup merre fjalën ,por ju lutem të mos e shtini në pa kufi. Urdhëroni.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

Z. kryetar të nderuar deputetë.

Partia Demokratike dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i respekton edhe demokracinë e brendshme e dhe diskutimet individuale të deputetëve, por diskutimi i Nait Hasanit është diskutim individual, qëndrim individual, nuk është qëndrim i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Ne mendonim se nëse ka ministri ndonjë vërejtje në këtë, mund ta thotë, por mendojmë që ky ligj duhet të miratohet dhe nuk ka nevojë për asnjë shtyrje dhe për asnjë diskutim.E miratojmë ligj e jo historinë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Faleminderit. Nekibe, urdhëro, shkurtimisht.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI

Po më duket se është përvjedhur një gabim teknik në amendamenti 20 ka mbetur pa u përfunduar,prandaj po votojmë në pako.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Amendamenti 1

Regjia le të bëhet gati, për votim dhe votojmë tani:

Për 68;
Kundër asnjë.

Ka kaluar amendamenti 1.

Amendamenti 2

Bëhemi gati për votim dhe votojmë tani

Për 72;
Kundër 2.

Ka kaluar amendamenti 2.

Neni 3, treshi ka kaluar, do të thotë votojmë për amendamentin 3.

Amendamenti 3

Regjia le të bëhet gati votojmë tani:

Për 72;

Asnjë kundër.

Ka kaluar amendamenti 3.

Amendamenti 4

Urdhëroni Gjergj Deda

DEPUTETI GJERGJ DEDA:

Mendoj se në këtë amendament, pika 6, ndoshta s'e kam të qartë, por kam dëshirë të sqarohet kujt i thuhet viktimë civile e luftës, a konsiderohen personat të vdekur nga pasojat e luftës në Kosovë, data është këtu dhe nuk e kam të qartë, u morëm vesh për dëshmorët çdo respekt, por nëse thuhet se jetimi është me vajë në buzë, atëherë jetimët disi kanë mbetur në familjet e dëshmorëve dhe të viktimave, sepse deri më tash shoqëria e Kosovës, pa marketing, nuk ka treguar respekt minimal.

Tash shtrohet pyetja? Nëse të vrarët në Reçak, Prekaz, Meje, Korenicë, Krushë, do me thanë, janë të vrarë nga forcat serbe, si mund të thuhet këta kanë vdekur nga pasojat dhe si viktima civile. Mendoj se janë ata që nga zhvendosja kanë pasur aksident komunikacioni, por s'kanë pasur medikamente nëse kanë qenë të sëmurë, të moshuar, janë rrëzuar këto mund të jetë se kanë vdekur në kohën e luftës, ndërsa ata që janë pushkatuar, janë vrarë i kanë hedhur në zjarr, janë marrë eshtrat e tyre dhe i kanë dërguar në Serbi, ku mbahen ende në Serbi, pra t'i quajmë të vdekur, t'i vlerësojmë kështu mendoj se është gabim dhe është johumane, kështu edhe atëherë do t'ju kujtohet se s'është shumë me rëndësi t'ju kujtoj. Kam pas kërkuar që përveç dëshmorëve të kombit, ta kemi edhe kategorinë e martirëve të luftës, do me thënë tash kemi të bëjmë me tri kategori dëshmorësh të kombit – respekt për ta – pastaj martirët e lirisë dhe këta që janë viktima civile, do të thotë si e kemi paraparë në pikën 6 të këtij amendamenti. Ma merr mendja se nuk është mirë të ngutemi, se edhe ashtu jemi vonuar dhe do të ishim shumë të ofenduar familjet që kanë anëtarët e tyre të vrarë, do me thënë nëse këta quhen persona të vdekur gjatë luftës, këta s'janë persona të vdekur gjatë luftës por këta janë persona të vdekur gjatë luftës e janë martirë dhe duhet të kenë vendin e merituar edhe në ligj edhe në shoqërinë e Kosovës. Faleminderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Gjergj unë nuk jam ekspert, ekspert këtë e kanë bërë e ju lus ai që është ekspert, asnjë ligj që e kemi miratuar nuk ka qenë 100% i përsosur, prandaj le t'i kem sqarimet por kanë punuar shumë ekspertë dhe vendor e kemi zgjatë na kanë lutë edhe ekspertët edhe që e kanë kaluar luftën. Urdhëroni nëse ka dikush fjalime jo, jo ne do të shkojmë ta amendamentojmë. Urdhëro doktoreshë.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI

Mbarimi i jetës është vdekja pa marrë parasysh qysh është kryer një jetë a është pushkatuar a është mbytë a ka vdekur e ka pësuar në aksident komunikacionit mbarimi i jetës është vdekja në atë është menduar dhe ajo dihet, nuk e di pse këtu është e pa qartë .

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Faleminderit. Regjia bëhemi gati, e dëgjuam, mund të mos e votoni, Emrush a je ekspert t'i mjekësisë ligjore vëllai jam hajt merre fjalën.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI

Amendamenti 4 ju lutem, amendamenti 4 pika 1 edhe pika 5 po kuptohet mos t'i përsërisë ato çka i tha Nait Hasani e këtu nuk jemi tu bë histori është e vërtetë po nuk do me thanë se duke e miratuar këtë ligj me thanë pavërteta. Kështu që data duhet të korrigojohet në pajtim me atë çka e tha Naiti, do me thanë në vend të datës 30 dhjetor 91 duhet të jetë 17 nëntor 94, ju lutem ku është marrë kjo datë le ta sqarojë Komisioni që e ka përcaktuar sepse para kësaj date nuk është përmend UÇK-ja askund as publikisht as nëpër qarqe që kanë vendos lidhur me këtë, së paku nuk është vendos deri me këtë datë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit.

Unë jam këtu me respektuar procedurën dhe rregullat, regjia bëhemi gati për votim, mos e votoni ju lutem, ne duhet të kemi hy në procedurë dhe duhet të procedojmë. Regjia bëhemi gati për votim, dhe votojmë tani.

Për	69;
Kundër	9.

Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 5

Përgatitemi për vendimmarrje dhe votojmë tani:

Për	77;
Kundër	1.

Ka kaluar amendamenti 5.

Amendamenti 6

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për	75;
Kundër	2.

Ka kaluar amendamenti 6.

Në amendamenti 7 ka ministri, po një herë ministri ka përparësi.

Urdhëro z. ministër.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ

Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë, kolegë ministra.

Konsideroj se është një gabim teknik te amendamenti 7 neni 5 pika 4 i cili bie në kundërshtim me amendamentin 9 neni 7 pika 4, këtu është e paraparë shkalla e invaliditetit në amendamentin 7, ndërsa në amendamentin 9 duke pas parasysh shkallën e invaliditetit do të bëhet një kompensim për invalidin e luftës i cili e ka këtë shkallë ndërsa te amendamenti 9 thuhet se do të jenë shërbimet primare, sekondare dhe terciare do të jenë falas, thjeshtë duhen të korrigojohen, është një gabim teknik, duhet të korrigojohet vetëm hiqet shkalla që është 41%.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ministër faleminderit, Zylfije.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI

Vetëm desha me plotësuar ministrin se e pata për nenin e njëjtë, por le të mbetet siç ka qenë më herët në ligj 13.5 shërbimet shëndetësore falas se bie ndesh me nenin 9 e njëjtë është, ato çka i tha edhe ministri.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ju lutem amendamenti 7 me përmirësimet që u thanë këtu, përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

Amendamenti 7

Për	63;
Kundër	4.

Ka kaluar amendamenti 7.

Amendamenti 8

Regjia përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për	68;
Kundër	3.

Ka kaluar amendamenti 8.

Amendamenti 9

Përgatitemi për votim, Sabri Hamiti edhe Naim Jerliu, në punë, përgatitemi për votim dhe votojmë tani pa debate, po çfarë demokracie tri vjet një ligj s'po mund ta aprovoni, me demokraci, jo unë e kisha aprovuar në mandatin e kaluar me pas pyt.

Për 69;
Asnjë votë kundër.

Ka kaluar amendamenti 9.

Amendamenti 10

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 74;
Kundër 1.

Ka kaluar amendamenti 10.

Amendamenti 11

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 73;
Kundër 1.

Ka kaluar amendamenti 11.

Amendamenti 12

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 70;
Kundër 2.

Ka kaluar amendamenti 12.

Amendamenti 13

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 74;
Kundër 1.

Ka kaluar amendamenti 13.

Amendamenti 14

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 71;
Kundër 1.

Ka kaluar amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 73;
Kundër 2.

Ka kaluar amendamenti 15.

Amendamenti 16

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 75;
Kundër 2.

Ka kaluar amendamenti.

Amendamenti 17

Gani Koci, pastaj Naim Maloku, urdhëroni. Urdhëro Gani.

DEPUTETI GANI KOCI

Rreth dhënies së dokumentacionit për verifikimin e statusit të veteranit të dëshmorit ose invalidit të luftës në praktikat e vendeve tjera gjithmonë janë organizatat që dalin nga lufta si lidhjet e luftëtarëve të ne kemi Organizatën e Veteranëve të Luftës, Organizatën e Invalidëve të Luftës dhe këtu unë mendoj se është bërë një gabim në këtë amendament ku thuhet se në mbështetje të dokumentacionit që e lëshon Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së dhe në bashkëpunim sipas nevojës, kjo sipas nevojës më duket se është e tepërt këtu se për të verifikuar statusin edhe organizimin janë organizatat që dalin nga lufta dhe ato duhen të jenë mos në radhë të parë atëherë Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së në bashkëpunim me organizatën e veteranëve të luftës të UÇK-së , Organizatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së dhe Organizatën e familjeve të dëshmorëve dhe të bëhet ky plotësim këtu dhe të hiqet kjo sipas nevojës. Nuk di mendimin e ministrit rreth kësaj por unë konsideroj se kështu duhet të jetë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

U faleminderit Naim Maloku, jo ministri këtu nuk vendos deputetë kemi hy në procedurë.

DEPUTETI NAIM MALOKU

Faleminderit kryetar.

Unë i bashkëngjitem mendimit të deputetit Gani Koci vetëm të hiqet kjo sipas nevojës ju lus deputetët që të përkrahet ky propozim.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Unë, e atëherë ministri funksionon Bujar, si deputet po urdhëro.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI

Unë si deputetë këtu po flas, në rregull do të ishte që në rend të parë dokumentacionet e lëshuara nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe të konfirmuar nga Shtabi i Trupave të Mbrojtëse të Kosovës duhen të jenë ato kryesore të cilat përcaktojnë këto kategori. shoqatat janë ndihmesë dhe shoqatat duhet t'ju ndihmojnë vazhdimisht implementimin e këtij ligji nga organet kompetente nga Ministria.

Unë konsideroj që vetëm këto dy organe Shtabi i Përgjithshëm në bazë të dokumenteve që i ka lëshuar gjatë periudhës së luftës deri në transformimin e UÇK-së dhe Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së si vazhdimësi i strukturës së UÇK-së janë dy organet kompetente që mund t'i lëshojnë këto. Shoqata vazhdimisht rriten dhe ka shoqata ndryshme ato duhet të mirën në konsideratë por mendoj që organi qeveritar Ministria përkatëse duhet bazë kryesore të ketë dokumentacionin e këtyre dy mekanizmave njëri që ka vepruar gjatë luftës deri në përfundim të luftës dhe vazhdimësia e saj. Mendimi imë është kështu. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Faleminderit, Nekibe Kelmendi si juriste dhe avokat,. urdhëro Nekibe, cila prej këtyre të merret dhe të ecim më tutje.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI

Mendoj se ky amendament: Neni 1, duhet të përfundojë me fjalën “TMK-së, pa bashkëpunim sipas nevojës me shoqatat e dala nga lufta në përputhje me aktet nënligjore të këtij ligji”. Mundet edhe kjo në aktet nënligjore të këtij ligji, kurse në bashkëpunim sipas nevojës me shoqatat e dala nga lufta ,ato mund ta ndërrojnë emrin edhe të ndryshohen. Ato janë shoqata, nuk janë institucione, janë organizata joqeveritare.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Gani do t'ju lus të mos bëjmë polemika- të lutem. Urdhëroni edhe një herë.

DEPUTETI GANI KOCI

Nuk e thashë rastësisht. Urdhëroni shikoni vendet , shtetet dhe popujt e tjerë që kanë bërë luftëra çlirimtare dhe zakonisht organizatat që kanë dal nga këto lufta me anëtarë që kanë qenë pjesëmarrës të këtyre luftërave, nuk janë krejt shoqata civile, por shoqata nën përkujdesje të Qeverisë dhe si e tilla të jenë edhe këto shoqata që kanë dal nga lufta dhe po të kemi përvojë, ndoshta këtu nuk ka të atyre të LNÇ-së bijë e bija, por edhe nga ajo

përvojë e së kaluarës gjithmonë dokumentacioni është lëshuar nga këto shoqata. Statusi i këtyre shoqatave thotë se anëtarët e këtyre shoqatave janë vetëm pjesëtarët të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të përcaktuara në periudhën brenda një kohe të caktuar. Ata që nuk kanë qenë pjesëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mund të bëjnë 100 shoqata, por jo t'i quajnë shoqata të veteranëve as të invalidëve të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj, si i tillë është një institucion që është kompetente të jap mendim. Pajtohem me atë që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka bërë dokumentacion dhe se ky dokumentacion është në Shtabin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Sot ose nesër ai dokumentacion do t'u lihet edhe organizatës së veteranëve të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kjo, sipas nevojës, të hiqet. TMK-ja do të transformohet, do të vijë njerëzit që s'kanë qenë kurrë në luftë, vetëm kanë dëgjuar për luftën. Prandaj, nuk mund të hiqen organizatat e dala nga lufta. Në këtë amendament duhet të hiqen fjalët "sipas nevojës" dhe të jetë jo sipas nevojës po detyrimisht në bashkëpunim me shoqatat e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ju faleminderit. I kemi dëgjuar me vëmendje të gjitha. Ne procedojmë me atë qysh e kemi marrë si material.

Regjia të bëhet gati. Procedojmë sipas propozimeve të Komisionit FunkSIONAL .

Bëhemi gati për votim dhe votojmë tani.

Për	63;
Kundër	16.

Ka kaluar amendamenti 17.

Amendamenti 18

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për	80;
Kundër	1.

Ka kaluar amendamenti 18.

Amendamenti 19

Bëhemi gati për votim dhe votojmë tani:

Për	75;
Kundër	1.

Ka kaluar amendamenti 19.

Amendamenti 20

Sabri Hamiti, urdhëro prof.

DEPUTETI SABRI HAMITI

Te neni 20 e 18.2. kur numërohen ligjet që duhet të hartohen .Ligji për njohjen e statusit të veçantë të komandantit legjendar të UÇK-së për Adem Jasharin dhe ky katërshi , njohja e statusit të veçantë të familjes Jashari. Nuk bën të futen në thonjëza këto se kjo bëhet etiketë, këtu s'ka lidhje me kurrfarë etikete, por me një njeri konkret që e ka emrin Adem Jashari edhe me familjen Jashari. Ky është thelbi pse duhet të hiqen thonjëzat dy herë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Prof. faleminderit Mendoj se s'kemi koment për këtë, sepse kështu është.

Përgatitemi për votim,me përmirësimin ajo është më kompetente për këtë, nuk është çështje juridike, po është çështje e shkencës. Ministri Shatri

MINISTRI HAKI SHATRI

Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë.

Nuk e kam asnjë vërejtje as koment Kuvendi i ka miratuar amendamentet dhe mendoj se duhet të respektohen, por dua t'ju them, në mënyrë që të mos bëhemi premtues të kotë. Vërejtja që e ka dhënë Komisionit për Buxhet , në pjesën ku jepet vërejtjet për amendamentet duhet të gjejë vend në nenin 20. Fjalën e kam për kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, konkretisht në pjesën që ka të bëjë me implikimet buxhetore. Ju lus të keni mirëkuptim,sepse të gjithë e dimë situatën, buxheti është miratuar për vitin 2006,sepse ligji sipas kësaj që shkruan këtu,hyn në fuqi ditën që miratohet në Kuvend,pra në ditën që nënshkruhet nga Përfaqësuesi Special. Mund të jetë pas një jave, kurse mundësia për t'u përgjigjur për të gjitha këto obligime që nxjerr ligji tash për tash, sa kemi të dhëna ,është e pamundur të respektohet në tërësi. Që të mos bëhemi vetëm premtues të kotë, ju sugjeroj se duhet ta kemi parasysh t'i materializojmë vërejtjet e Komisionit për Buxhet në dispozitat e ligjit. Konkretisht me amendamentin 20. Faleminderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ministër edhe kryetarit të Komisionit i dhamë mirënjohje për punën dhe askush nuk e kontestoi, as juve askush nuk ju kontestoi. Por ne t'u themi njerëzve se duhet të presin 2008, ose 2018 ose 2007, nuk është porosi e ligjit. E kuptoj vështirësinë dhe ju thashë profesionalisht Parlamenti po e përkrah, bashkërisht Qeveria dhe parlamenti do të përpiqen të gjejnë forma plotësuese për atë që është e mundshme, që ana morale të

plotësohet. Nëse sot ka mundësi për një euro, le të plotësohet. Ne duhet ta bëjmë maksimumin si institucioni kur mundemi, prandaj ligjin ta procedojmë ashtu siç ka ardhur në Parlament. Në qoftë se deputetët mendojnë të mos e miratojmë, hyjmë në procedurë. Regjia të bëhet gati për votim.

Bëhemi gati për votim dhe votojmë tani:

Për	74;
Kundër	2.

Prandaj konsideroj se është miratuar edhe amendamenti 20. Ky ishte i fundit.

Kërkoj nga regjia të bëhet gati të votojmë për Ligjin me amendamente e miratuara sot.

Bëhemi gati për votim dhe votojmë tani:

80 deputetë kanë votuar për Ligjin me amendamentet e miratuara. 2 vota janë kundër. Konsideroj se u miratua Ligji.

Më lejoni t'ju falënderoj nga zemra dhe t'ju kërkoj falje. Nuk kam pasur tendencë ta ofendoj ndonjë deputetë, komision as ndoken tjetër, por ishte e nevojshme që pas dy tre vjetësh punë të përbashkët sot ta finalizonim. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për banimin

Vërejtje hyrëse. Projektligji për banimin (nr. 02L/19) është miratuar në parim në seancën plenare të mbajtur më 23 shkurt 2005. Komisioni për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision FunkSIONAL dhe përgjegjës raportues ka përfunduar shqyrtimin e Projektligjit në fjalë, mirëpo për shkak të implikimeve financiare që do të shkaktoheshin gjatë zbatimit të tij Komisioni funksional dhe Komisioni për Buxhet nuk kanë arritur të gjejnë mendim unik lidhur me këtë projektligj.

Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, duke pasur parasysh mospajtimin e Komisionit për Buxhet, vendosi që Kuvendit t'ia paraqiste rekomandimin e datës 13 dhjetor 2005 me propozim që Projektligji t'i kthehej propozuesit- Qeverisë së Kosovës për rishqyrtim..

Rekomandimi i Komisionit funksional u është shpërndarë të gjithë deputetëve, arsyetimin për t'i mbështetur këto rekomandime mund ta paraqes kryetari i Komisionit z. Rifat Krasniqi.

Z. Krasniq, foltorja është për ju. Urdhëroni.

DEPUTETI RIFAT KRASNIQI

Faleminderit z. kryetar. fFalën do t'ia japë, nënkryetarit Lulzim Zenelit. Urdhëro z. Zenel.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Delegimi po funksionon , urdhëro z. Lulzim.

DEPUTETI LULZIM ZENELI

Faleminderit z. kryetar.

Nuk kam çka të shtoj, përpos asaj që kanë thënë më parë. Të gjithë deputetët e kanë marrë rekomandimin e komisionit funksional dhe në bashkëpunim me Komisionin për Buxhet i rekomandon Kuvendit ta miratojë këtë raport, në mënyrë që ky projektligj të implementohet në fazën kur të jetë i gatshëm edhe të miratohet. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Faleminderit. Bëhemi gati për votim, për ta miratuar rekomandimin dhe votojmë tani:

Për	68;
Kundër	3.

Konsideroj se është miratuar rekomandimi.

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore, të lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 23.12.2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'u adresohen për shqyrtim komisionit funksional përgjegjës për raportin dhe komisioneve kryesore.

Ftohet ministri Agim Veliu që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë Projektligjin. Ministër urdhëroni.

MINISTRI AGIM VELIU

Faleminderit i nderuari kryetar, të nderuar deputetë.

Projektligji për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore të lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, përfshin fushën ligjore shumë të rëndësishme e të nevojshme dhe MASHT është duke punuar në përgatitjen e bazës ligjore për avancimin e procesit arsimor, si dhe për krijimin e standardeve të pranuar të arsimit evropian.

Arsyeja e nxjerrjes së këtij ligji

Është krijimi i kushteve për funksionimin e rregullt ligjor, për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore, të lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik.

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Përcaktimin e parimeve dhe të normave themelore për zhvillimin e veprimtarisë së botimit të teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik.
2. Përcaktimin e konceptit tekst shkollor, mjet mësimor, lekturë shkollore dhe dokumentacion pedagogjik dhe rregullimin e kushteve të hartimit, lejimit dhe të botimit të tyre.
3. Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të MASHT-it dhe të botuesit.
4. Krijimin e kushteve për konkurrencë të lirë për botimin e tekstit shkollor, të mjetit mësimor, të lekturës dhe të dokumentacionit pedagogjik.

Nevoja

Është nevojë e kahershme që Kosova ta kishte Ligjin për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik, që është bërë më i domosdoshëm në fazën e tanishme, kur gjendemi në proceset e ndryshimeve dinamike në Kosovë, rajon e më gjerë.

Prandaj MASHT-i hartimin e këtij ligji e ka parashikuar si çështje urgjente dhe me prioritet të lartë për funksionimin ligjor në botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore dhe të dokumentacionit pedagogjik.

Rëndësia

Ligji ka rëndësi të madhe për shoqërinë kosovare, i takon natyrës së zhvillimit të arsimit dhe ofron përparimin e konkurrencës në Kosovë. Ligji ka rëndësi të madhe praktike për nevojat e gjithmbarshme të arsimit në Kosovë dhe për përfituesit e shërbimeve arsimore, sepse ngrit cilësinë e shërbimeve në kuadër të zhvillimeve e të proceseve kombëtare e ndërkombëtare. Ky ligj ka për qëllim krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e arsimit dhe të aftësisimit në pajtim me zhvillimet dhe arritjet e reja të harmonizuara me standardet ndërkombëtare lidhur me arsimin dhe me edukimin në Kosovë.

Puna në përgatitjen e këtij ligji

Në përgatitjen e këtij ligji konsultuar literaturë e ndryshme dhe është hartuar në pajtim me kushtet dhe rrethanat e Kosovës. Në hartimin e këtij ligji kanë marrë pjesë ekspertë të MASHT si dhe ekspertë nga shtëpitë botuese dhe institucionet e tjera. Gjatë hartimit të

Ligjit janë konsultuar ligjet e vendeve të Bashkimit Evropian, si; legjislacioni francez, gjerman, austriak, italian dhe kroat.

Standardet

Ligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik ka cilësinë e nivelit të standardeve të pranuar evropiane dhe është në harmoni me praktikën e standardeve vendore dhe të atyre ndërkombëtare e sidomos të BE-së.

Risite dhe avancimet

Ligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, është një risi në legjislacionin e tanishëm. Ky ligj paraqet konkurrencën e shtëpive botuese në botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore dhe të dokumentacionit pedagogjik më cilësor, në pajtim me zhvillimin e proceseve ndërkombëtare.

Përmbajtja e ligjit

Dispozitat e përgjithshme

- a. preambula /përkufizimet;
- b. qëllimet e ligjit;
- c. kërkesat që duhet t'i përmbushin tekstet shkollore, mjetet mësimore, lekturat shkollore dhe dokumentacioni pedagogjik;
- d. procedura e hartimit, lejimit dhe botimit.

Vlerësimi dhe lejimi i teksteve shkollore, i mjeteve mësimore dhe dokumentacionit pedagogjik i

- a. tenderi;
- b. vlerësimi i dorëshkrimeve;
- c. juritë e vlerësimit të dorëshkrimeve;
- d. zgjedhja e dorëshkrimeve;
- e. vendimi për botim;
- f. lejimi i teksteve, i mjeteve mësimore dhe i dokumentacionit pedagogjik pa tender.

Të drejtat dhe detyrimet e botuesit

- të drejtat e botuesit;
- detyrimet e botuesit.

Përdorimi i teksteve shkollore

- katalogu;

- e drejta e mësimdhënësit për përdorimin e tekstit në shkollë.

4. Dispozitat ndëshkimore

5. Hyrja në fuqi

Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër ju faleminderit.

Unë do të ju lutja që t'i shlyeni në ekrane kam prej ligjit të mëparshëm Demir Lima, Naser Osmani, Nimon Alimusa besoj për këtë është në emër të LDK-së. Nimon foltorja është për ju.

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ

Faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra dhe ju kolegë deputetë.

Nuk ka dyshim se kur arsimit ynë u gjend, pas luftës, në rrethana krejtësisht të reja, u paraqit nevoja e ngutshme edhe për legjislacion krejtësisht të ri ,madje edhe për ndonjë ligj që nuk e kemi pasur më parë, siç është ky që po e trajtojmë sot. Dhe në legjislacionin e arsimit risi e mirë erdh hartimi i Ligjit për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore të lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik. Mungesa e një ligji të tillë deri më sot mund të konsiderohet mangësi e legjislacionit të sferës së arsimit në fazën që e lamë pas. Tash kur Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë po harton strategjinë për arsimin në të ardhmen, ka bërë mirë që nxjerrjen e këtij ligji e ka konsideruar prioritet të ngutshëm.

Ky projektligj e rregullon një sferë shumë të rëndësishme të arsimit tonë. Nga një lexim i kujdesshëm i këtij teksti të ligjit , mund të hetohet se në hartimin e tij, siç u tha, kanë dorë ekspertë sferash të ndryshme ,që i ka objekt ky ligj, por janë konsultuar ligjet e vendeve të ndryshme dhe si rezultat i kësaj,sipas nesh, doli një projektligj i mirë. Pra ,sipas nesh ky tekst ligji i plotëson objektivat që i pretendon një tekst i mirë ligji siç janë: lexueshmëria, qartësia, kuptimi i lehtë, referencat, konciziteti, qëndrueshmëria, kuptueshmëria e termave, tabelimi i mirë etj. Kjo nuk do të thotë se ky tekst ligjor ka dalë krejtësisht pa mangësi, ka disa dispozita që kanë nevojë për plotësime e saktësime. Kështu për shembull në pjesën ku jepen përkufizime ka nevojë të plotësohen e të saktësohen disa terma ta zëmë nocioni, dokumentacioni pedagogjik dhe nocioni dokumentacion shkollor, janë paraqitur sikur të kishin koncept të njëjtë, ndonëse kuptimi i tyre është i ndryshëm dhe kjo i referohet bashkë titullit të ligjit. Po ashtu disa nene kanë nevojë për saktësime, siç janë neni 3.1, 3.4, 5.2, 14.2. etj. etj.

Projektligji ka edhe mangësi të tjera, siç është për shembull askund nuk përmendet edukimi parashkollor. Këto mangësi lehtë mund të evitohen, sepse marrë në tërësi, ky tekst ligji paraqet bazë të mirë mbi të cilën mund të dalë në fazën e dytë një ligj i mirë.

Pra grupi ynë parlamentar përkrah në parim këtë projektligj dhe do të japë kontributin e vet për fazën e mëtutjeshme për ta përsosur më tej. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit, Nuran Malta, në emër të Grupit 6+ . Le të paraqiten grupet e tjera. Sabri Hamiti le të përgatitet.

DEPUTETI NURAN MALTA:

Sayın başkan, sayın bakanlar, sayın milletvekilleri

Görüşmekte olduğumuz ders kitaplarının basımı, okul araçları, okul lektürleri ve pedagojik dokümanlar yasam tasarısının eğitimdeki plan ve programlarının devamlılığı ve başarısı için gerekliliği şüphesizdir. Bu tasarı okul kitaplarının, önceliklerinin belirlenmesi açısından, ayrıca Kosova'nın yeni yapılanma sürecinde eğitimdeki plan ve programlarında yapılan reformların gerçekleşmesi için önemlidir.

“6+” grubu olarak bu tasarının çalışma grubunun isimleri verilmemektedir.

Elimize geçen son son birkaç tasarıda çalışma grubunun isimleri verilmemektedir.

Eğitim konusu tüm toplumlarda önemli olduğu gibi bizim için de önemlidir. Bu gibi yasaların çalışma gruplarını görmek ve azınlık temsilcilerinin de olması gerektiğini bir daha belirtmek istiyorum. Ayrıca tasarıda teknik açıdan bazı yanlışlıkları bulunmakta, Arnavutça, İngilizce, Sırpça versiyonlarında bazı maddeleri birbirin uymadığı ve yanlış yazıldığı görülmektedir. Mesela 3.3. ve 3.4 maddesi tasarının 4. maddesinde kitapların hazırlanması ve basım şartları sıralanmıştır.

Öncelikle eğitim bakanlığından Türkçe 15 kitabın çıktığını belirtmek ve teşekkür etmek istiyorum.

Tirajı az olan kitaplarımızın bir basım evi tarafından ısmarlanması zor olduğu için azınlıklara bundan böyle de pozitif bir ayrımcılık yapılması, kanatimizce çok önemlidir. Diğer uyarı ve önerilerimizi komisyon çalışmalarında vermeye çalışacağız.

Dikkatinize teşekkür ederim

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Faleminderit. Do t'i lus deputetët të rrinë pak më larg mikrofonit, prof. pasi ua kam dhënë fjalën ,të paraqiten grupet. Urdhëron Sabri Hamiti, pastaj të bëhet gati Sala Ahmetaj. Urdhëro

DEPUTETI SABRI HAMITI

Faleminderit z. kryetar, kolegë të nderuar dhe ministra.

Nëse do ta kualifikoja me shprehje të shpejtë këtë ligj,se pari , do ta quaja i domosdoshëm dhe se dyti ligj i mirë. Me të vërtetë këtë përkufizim do ta thosha ,duke pasur parasysh që ky ligj me një fushë të jashtëzakonisht për jetën tonë shoqërore i krijon dy risi, krijon ligjërisht konkurrencën dhe se dyti lejon tekste alternative. Këto janë dy elemente të rëndësishme që nuk janë vetëm mundësi që të kodifikohet një veprimtari e botuese e rëndësishme për shoqërinë, po që në të vërtetë, drejtpërsëdrejti ndikojnë në përmirësimin e nivelit të arsimit. Deri më tash asnjëherë nuk kemi pasur mundësi të kishim të sanksionuar me leje të Ministrisë tekste alternative, prandaj nuk ka pasur konkurrencë të vërtetë. Me të vërtetë unë kam dhënë një fjalë të veçantë për punën rreth këtyre ligjeve dhe kësaj Ministrie, sepse në një mënyre ata që e kanë përcjellë punën rreth hartimit të programeve të reja mësimore dhe të sistematikës e të strukturës së re mësimore, dinë se ligji në vërtetë po vjen si një sanksionim i një praktike jo krejt të përfunduar,por të provuar me sukses në vitet e fundit. Këtu,në këtë ligj, megjithatë janë dy tri probleme që duhet saktësohen.

Së pari problemi i autorit, sikur edhe shumë herë në ligje të tjera, këtu nuk është sanksionuar mirë MASHT-i merret shumë me botuesit që konkurrojnë me tekste anonime(pa emër) me shifra, mirëpo MASHT-i ,nëse merr tekstet dhe vlerëson të bëhen tekste të lejuara prej tij duhet të ketë kujdes për raportin autor – botues,sepse ka pas abuzime të jashtëzakonshme të botuesve me autorë që deri tash i kanë shfrytëzua keq, do me thënë këtu duhet të jetë një element, po e zëmë kur jepet leje për një tekst të kërkohet edhe një kontratë e botuesit me autorin.

Dhe se dyti është elementi i lekturës meqë raporti autor-botues rregullohet me tekstin që konkurron ,te lektura kemi situatë tjetër. Lektyra është gjë që përcaktohet me program dhe duhet të saktësohet kush, në çfarë mënyre konkurron dhe e boton lektyrën, sepse ai është tekst i fiksuar , programi është i fiksuar dhe ju do të keni një konkurrencë të egër, kush i boton lektyrat, e dini shumë mirë që kjo konkurrencë e egër, por ndodh edhe me tekstet shkollore, sepse po botohen tekste të huaja , ka botues me shifra të ndryshme që botojnë të njëjtin tekst. Këto dy probleme duhet të saktësohen dhe mendoj se teksti i ligjit është shumë funksional. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ju faleminderit. Fjalën e ka Sala Ahmetaj , kurse të përgatitet Mazllum Kumnova

DEPUTETJA SALA AHMETAJ

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë.

Ligjin që kemi përpara e kemi shikuar me vëmendje. Kemi shumë vërejtje për të cilat deshëm të flisnim këtu,i përmendëm , por tash do të flasim vetëm disa prej tyre.

Ligji që po e shqyrtojmë synon t'i përcaktojë parimet dhe normat themelore të kësaj veprimtarie, duke synuar gjithashtu edhe strukturimin dhe sistemimin e koncepteve: tekst shkollor, mjete mësimore, lektyrë shkollore, dokumentacion pedagogjik etj. Dhe ligjësimin e kushteve të hartimit dhe të botimit të tyre, duke përfshirë edhe konkurrencën e lirë si një nga vlerat e demokracisë.

E përkrahim në parim këtë projektligj, por i kemi edhe disa vërejtje në parim sidomos rreth disa koncepteve dhe nocioneve. Pastaj kemi vërejtje edhe rreth disa çështjeve të strukturës së Ligjit. Kompetencat dhe përgjegjësitë duhej të qartësoheshin më mirë, Ne do t' marrim edhe disa shembuj konkret p.sh. neni 14 që lejon edhe mundësi alternative që për ne nënkupton edhe një vlerë të demokracisë. Mirëpo kujtojmë se kjo zgjidhje alternative mos rastësisht mund të shndërrohet në zgjidhje arbitrare, prandaj, rreth kësaj çështjeje ne mendojmë se do të duhej të futej edhe ndonjë nen dhe të qartësohej më mirë çështja e zgjedhjes së teksteve që mund të bëhet nga arsimtari.

Kemi edhe disa vërejtje të tjera ,sidomos te nenet 7 ,pastaj të neni 4, do me thënë rreth procedurës së hartimit dhe të botimit të teksteve edhe për juritë e vlerësimin të dorëshkrimeve. Ne mendojmë se këtu, tek neni 4 ,do të duhej të futeshin edhe 2 nene të tjera, sepse mendojmë se me të njëjtin nen nuk mund të parashihet edhe hartimi i tekstit, për të cilin do të duhej të shpallej konkursi, kurse për botimin e tij natyrshmit se duhet të shpallet tenderi.

Ose edhe te neni 7 juritë e vlerësimit të dorëshkrimeve ,sepse mendojmë se dorëshkrim mund të sjellin edhe autorët e pavarur,që nuk i përkasin ndonjë shtëpie botuese, do të thotë duhej të ishte e drejta pa kufizime.

Më gjithë këto vërejtje mendojmë se ky është ndër ligjet më të mira që ka ardhur në Kuvend dhe pas dëgjimit publik që do të bëhet, në të cilin shpresojmë se do t'i qartësojmë edhe disa dilema për disa nene të caktuara, shpresojmë se do të miratohet në Kuvend pas amendamentimit të nevojshëm. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ju faleminderit, Mazllum Kumnova, të përgatitet Genc Gorani.

DEPUTETI MAZLLUM KUMNOVA

Z. kryetar Grupi i AAK-së në këtë Kuvend e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore,të lektyrës shkollore dhe të dokumentacioni pedagogjik dhe me këtë rast ka konstatuar se për një kohë brenda një viti po i procedojmë tri projektligje që kanë të bëjnë me librin edhe pse ky projektligj ,që e kemi në dorë ka të bëjë me librin shkollor dhe me dokumentacionin shkollor,por edhe me mjetet mësimore.

Kështu po i plotësojmë mangësitë e ligjeve duke rregulluar veprimtari të veçanta në fushën e arsimit, kulturës, artit, shkencës etj.

Projektligji pretendon t'i rregullojë disa çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me veprimtarinë e edukimit dhe të arsimit. Po ashtu së bashku ose veç e veç janë ndër përcaktuesit e cilësisë së procesit të edukimit dhe të arsimit në Kosovë. Ky projektligj pretendon që për herë të parë në historinë e librit shkollor në Kosovë t'i nxjerr në tregun e Kosovës tekstet alternative për shkollat tona. Si duket, më në fund, janë respektuar sugjerimet e specialistëve të kësaj veprimtarie se tekstet alternative mund të jenë ndër përcaktuesit e përmirësimit të cilësisë së procesit të edukimit dhe arsimit të një shteti.

Shtetet evropiane ka përvojë shumëvjeçare në këtë drejtim, por edhe në shtete që janë në fazat e tranzicionit po e zbatojnë. Prandaj ne në Kosovë nuk duhet të ngurrojmë dhe të përfitojmë nga kjo përvojë e përparuar për t'i zbatuar në shkollat tona, përkundër asaj se kërkohet një angazhim shtesë i mësimdhënësve, i shkollës, dhe i institucioneve të tjera të arsimit, T'i kthehemi projektligjit që e kemi në dorë.

Në shqyrtimin e parë mund të konstatojmë se Projektligji shoqërohet me realitetin e kërkesave të arsimit në Kosovë, mirëpo, kemi disa çështje që janë klasifikuar të diskutueshme. duke filluar nga emërtimi i Ligjit, shpjegimi i nocioneve dhe nga mungesa e disa dispozitave për ribotimin ose autorizimin e botimit të teksteve shkollore ose të teksteve të tjera të ashtuquajtura për përdorim jashtë klasës a jashtë shkollës. Nga përvoja e përparuar nga ndonjë shtëpi botuese a nga ndonjë shtet tjetër, qoftë edhe në fazën eksperimentale, gjithnjë me leje të përdorimit nga Ministria e Arsimit. Është konstatimi yni që përkufizimet e disa nocioneve, që u janë dhënë iu duhet përmirësim i teorisë së hartimit dhe i vlerësimit të teksteve shkollore, tjetër a do ta mbajnë përsëri emërtimin lekturë shkollore i konsumuar qe 50 vjet, pastaj çështja e klasifikimit të dokumenteve administrative që janë mësuar t'u themi dokumente pedagogjike, janë çështje që përsëri duhet të merret mendimi i ekspertëve duke përfunduar, Grupi i AAK-së ka konstatuar se ky projektligj duhet të përkrahet, por gjatë procedimit për disa çështje që i hapëm në këtë rast duhet t'i marrim në dorë e 'i përmirësojmë për të cilat jemi të gatshëm.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit Genc Gorani të përgatitet Fetah Berisha

DEPUTETI GENC GORANI

Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra, zonja dhe zotërinj deputetë.

Ky projektligj është një nga projektligjet kornizë, do ta kisha quajtur, ligj që ndihmon shumë aktivitetin në këtë sferë dhe që do t'u jap baza shumë të rëndësishme atyre që merren me këtë problematikë.

Rëndësia e veçantë e këtij projektligji konsiston që në atë se i trajton tekstet shkollore që do të jenë në përdorim te fëmijët, në veçanti edhe të moshës parashkollore dhe besoj se për të ardhmen e sistemit shkollor kosovar është një prej projektligjet më të rëndësishme.

Natyrisht se ekziston komplementariteti ndërmjet këtij projektligji dhe projektligjeve të tjera, mirëpo ky kompletion në atë mënyrë që e rregullon një veprimtari që në se nuk do të ishte e sanksionuar me dispozita ,do të mund të dilte nga një kontroll dhe nuk do të mund të përcillej ashtu si duhet.

Me këtë rast kisha dashur të tërheqja një vërejtje në dy tri nene. Në nenin 2 që ka të bëjë me ndalimin e teksteve shkollore, në atë rast se cenohen të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore, nëse nxitet urrejtja politike nacionale ose fetare. Është relativisht lehtë të futet një dispozitë e tillë, duket apriori e nevojshme, mirëpo duhet ose të bëhet referencë ndonjë ligj tjetër, ku do të shihet se si mund të arrihet kjo me implementimin e këtij projektligji, ose në këtë projektligj është dashur të futej pjesa që merret me implementimin e këtij neni 2.

Në nenin 5 flitet për procesin e tenderimit. Është e qartë që duhet të ketë përkufizim specifik për këtë sferë sa i përket edhe procesit të tenderimit mirëpo, mendoj se është fundamentale që bëhet referencë në Ligjin e përgjithshëm të prokurimit, që të mos merret se këtu kemi të bëjmë me diçka që duhet të dalë jashtë këtij ligji, duhet të bëhet besoj në mënyrë eksplicite referencë në atë projektligj dhe eventualisht duhet të përmendim dispozitat të cilat janë specifike për këtë projektligj.

Kjo do të ishte e tëra grupi parlamentar ORA e përkrahë këtë Projektligj dhe do të merë pjesë natyrisht në komisionin funksional përkatës. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Ju faleminderit Fetah Berisha ,të përgatitet Zyhrije Maloku

DEPUTETI FETAH BERISHA

Faleminderit z. kryetar, respekt z. ministër të respektuar kolegë deputetë.

Dihet se arsimit është shtylla kryesore e një shteti demokratik. Arsimimi dhe edukimi i shëndetshëm i brezave krijojnë kuadro të afta të profesionesh të ndryshme që janë ardhmja e Kosovës. Edhe Kosova është në fazën e zhvillimit të reformave në arsim, prandaj të gjitha përpjekjet për mësimdhënie dhe mësimzënie të mirëfilltë janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e veprimtarisë së botimit të teksteve shkollore .të mjeteve mësimore të lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik dhe pikërisht sot në këtë seancë po debatojmë për Projektligjin e përpiluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,me të cilin sanksionohet kjo fushë e veprimtarisë botuese. Meqë arsimi po kalon fazën e reformimit në rrethana krejtësisht të reja, është bërë e nevojshme dhe e ngutshme që Kosova ta ketë edhe ligjin për botimin e teksteve shkollore mjeteve mësimore lekturës shkollore dokumentacionit pedagogjik. Është bërë zakon tani të thuhet se Projektligji është përpiluar nga ekspertë vendorë dhe nga ndërkombëtarët, se është bazuar në përvojën e këtij apo të atij shteti, gjë që është në rregull, por sidoqoftë rëndësia e këtij projektligji është i gjithanshëm, ngrit cilësinë me anë të konkurrimit si në pikëpamje shkencore, pedagogjike, ashtu edhe në pikëpamje të

harmonizimit me standarde ndërkombëtare, i cakton parimet dhe kushtet për hartimin, lejimin dhe botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore, të lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, si dhe konkurrencën detyrat përgjegjësitë dhe të drejtat e botuesit, përgjegjësit dhe të drejtat e autorit.

Të nderuar kolegë deputetë, Projektligjin këtë herë e kemi shqyrtuar bashkërisht me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesmeve të komunës së Rahovecit , në një takim të veçantë, duket se Projektligjin për tekstet shkollore e kishin lexuar me përkushtim dhe e kishin prurë në këtë takim vërejtjet dhe me sugjerimet me qëllime të mira që ligji të jetë sa më i përsosur, më funksional dhe më i zbatueshëm në praktikë. Ata dhe bashkërisht kishim vërejtje ,ndër to veçuan vetëm këto: neni 3 me pikat e veta duhet të riformulohet qartë, neni 5.3 ku bëhet fjalë për tenderin publik për botimin e teksteve shkollore, gjithashtu të riformulohet, ndërsa pika 4 të hiqet , po ashtu tek neni 11 ka shumë paqartësi, kur është fjala për vendimmartje, ankesat i drejtohen Komisionit afati dihet 15 ditë, sipas projektligjit. Më poshtë përdoret fjala, këshillë, pra a është komision apo këshillë? Mendoj se duhet të riformulohet.

Kemi menduar se këtu duhet të riformulohet në këtë mënyrë, puna e Komisionit për Ankesa të rregullohet me rregullore të punës së këtij komisioni ,që e harton Zyra ligjore e MASHT-it, por që edhe kjo duhet të ketë zyrën ligjore.

Vërejtja që aty u dha më shumë ishte: te burimet alternative, ku shkollave dhe arsimtarëve u ofrohet mundësia për ta zgjedhur tekstin që dëshirojnë ta përdorin: do të thotë ata ishin të mendimit se duhet të jetë një tekst i zgjedhur natyrisht sipas konkursit unik për lëndën e caktuar dhe për klasën e veçantë. Në fund të kihet parasysh dhe kujdes në lëshimet gjuhësore të formulimeve të neneve, me gjithë vërejtjet dhe sugjerimet që dolën këtu. Ne në parim e përkrahim këtë projektligj ,sepse është ligj mjaft i përkryer, ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit, Zyhrije Maloku le të përgatitet Naxhije Doçi

DEPUTETJA ZYHRIJE MALOKU

I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë

Sa i përket diskutimit tim lidhur me këtë projektligj, po them që në fillim se nuk do do ta zgjas shumë. .

Them kësi soji se duke u nisur nga përvoja e jetës së përditshme zakonisht kur duam ta kritikojmë dikën ,kemi diskutime të gjata që shpeshherë e tejkalojnë kohën e paraparë me Rregullore të punës së Kuvendit, por kur duam ta lavdërojmë, që kjo ndodhë më rrallë , diskutimet i kemi më të shkurtra.

Projektligji për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore, të lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, hyn në grupin e ligjeve të rëndësishme të sistemit të arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, andaj përgëzoj Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për hartimi e një ligji të tillë.

Ky ligj rregullon një materie që deri më tani pak a shumë ka qenë e rregulluar me disa rregullore të tjera por jo kështu sikurse rregullohet tani me këtë projektligj. Është hartuar mjaft mirë, duke e relativizuar problemin në të cilin është hartuar. Sa i përket materies të cilën e rregullon ky projektligj mendoj që është ma se i nevojshëm duke u nisur nga praktika e jetës së përditshme. Më e këtë sigurohet se qëllimi i synuar mund të arrihet pikërisht nëse zbatohet ashtu siç duhet në praktik.

Projektligji ka strukturë të mirë, materia është e përfshirë me pak nene por shumë i kartë dhe shumë konstruktiv, andaj përmbushë kriteret e miratimit në parim me pak vërejtje që ka dhe që i mbetet Komisionit funksional të bëjë plotësimin dhe korrigjimin e disa neneve.

Vërejtje kam në titullin e Projektligjit nuk mund të jetë drejtë shkruar titulli me dy parafjalë me parafjalën **për** dhe me parafjalën **mbi**, sepse nëse përdoret kështu titulli do ta humb kuptimin, mendoj se më mirë është të përdoret vetëm parafjala për, d.m.th. Projektligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik, e jo Projektligji për mbi botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore të lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik.

Te neni 11, të drejtat e votuesit, pika 2 thuhet: Ankesa i drejtohet Komisionit të Komisionit për ankesa në Ministrinë e Shkencës dhe të Teknologjisë, por shtrohet pyetja: a bëhet këtu për fjalë një apo për dy komisione?, kjo duhet të sqarohet më mirë.

Te neni 14, e drejta e mësimdhënësit për përdorimin e tekstit në shkollë, pika 1., Edhe këtu duhet të definohet më qartë, sepse ka raste kur mësimdhënësi përdor tekstin që nuk është shumë i përshtatshëm për nxënësin.

Projektligjin e përkrahë dhe do të votoj për miratimin e tij në parim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit Naxhije Doçi, le të përgatitet Ragip Zekolli

DEPUTETJA NAXHIJE DOÇI

Ju faleminderit z. kryetar, i nderuari kryetar Daci, e nderuara ministre Tërmerkollit i nderuari Ministër Veliu, të nderuar kolegë deputetë dhe të gjithë ju të pranishëm në sallë.

Në krijimin e një shteti funksional dhe të suksesshëm, ligjet e vlefshme dhe të bëra mirë, kanë rëndësi shumë të madhe dhe lirisht mund të themi se luajnë rolin primar në këtë aspekt.

Projektligjin për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore, të lekturës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik, është domosdoshmëri për arsimin në Kosovë. Edhe në praktikën e deritanishme në Kosovë përpiqeshim ashtu si kemi ditur dhe si kemi mundur, duke u përballur me vështirësi të natyrave të ndryshme t'i kishim në nivelin e kërkesave të nevojshme tekstet shkollore, mjetet mësimore, lekturën shkollore dhe dokumentacionin pedagogjik, por mangësia ishte se nuk kishim ligj të mirëfilltë, në të cilin do të bazoheshim për të punuar si duhet.

Me anë të këtij projektligji arsimit dhe edukimit në Kosovë do të zhvillohen dhe do të avancohet mirë i harmonizuar edhe sipas standardeve evropiane edhe sipas atyre ndërkombëtare. Në këtë projektligj ka risi dhe anë pozitive që ia vlen për t'i vlerësuar si të tilla, por që të jetë më i kompletuar ky projektligj, duhet të bëhen disa ndryshime si edhe të shtohen nene dhe pika në kuadër të neneve të caktuara. Që në hyrje ose parathënie të këtij projektligji në faqet 1 dhe 2, 3 janë përsëritur pa nevojë 4 pika, që në faqen 1 janë dhënë me pika të zeza me nëntitull çështjet e adresuara, ndërsa në faqen 2 dhe 3 i njëjti tekst është dhënë me numra rendorë dhe me nëntitull: Qëllimi, që të dyja këto tekste janë të njëjta dhe janë marrë nga neni 2 me nëntitull qëllimi. Gjithashtu në hyrje, me nëntitull Kostoja ku kryerreshtat i dyti dhe i pesti nuk kanë kuptim fare, po të lexohet teksti edhe në serbe dhe ai në anglisht mund të kuptohet. Teksti shqip, kryerreshti i pestë është në serbisht një periudhë e gjatë dhe kuptueshme, kurse në shqip ky kryerresht është ndarë në dy fjali me pikë dhe ka mbetur i gjymtë. Theksohet se në përgatitjen e këtij projektligji është punuar gjatë, dhe se grupi punues ka pasur parasysh legjislacionin francez, gjerman, austriak, italian dhe kroat. Pse nuk theksohen emrat e anëtarëve të grupit dhe se a ka qenë ndonjë anëtar i grupit njohës i hartimit të teksteve shkollore, apo ishte recensues i ndonjë teksti shkollor, por edhe i lekturave shkollore, apo-të paktën- a ka qenë ndonjë mësimdhënës që përditë ballafaqohet me kërkesat e titulluara në Projektligj.

Në nenin 3 paragrafi 2 theksohet se nuk lejohen tekstet, mjetet dhe as lektura shkollore të bëjnë propagandë kundër Kosovës, ose që nxisin urrejtje politike, nacionale dhe fetare. Në këtë nen propozoj të shtohet edhe ndonjë paragraf apo të shtohet ndonjë nen i veçantë, ku do të theksohej se tekstet, lekturat dhe mjetet e tjera, duhet të kenë përmbajtje të historisë dhe të kulturës kombëtare, në të cilat kanë munguar edhe nuk janë cekur sa i si duhet deri më tani.

Në nenin 6 bëhet fjalë për vlerësimin e dorëshkrimeve. Ka raste që tekstet, sidomos të lëndës së matematikës e të historisë për shkollat fillore të mesmet të ultat dhe të mesme të lartë, i përpilojnë profesorët e fakulteteve apo intelektualët të tjerë të profesioneve përkatëse, që nuk i njohin mirë planë programet e shkollave në fjalë, si dhe që nuk e njohin si dhe sa duhet psikologjinë dhe ndjeshmërinë e moshës së nxënësve.

Mendoj se është në të mirë të nxënësve që nenit 6 t'i shtohet edhe ndonjë paragraf tjetër, ku do të precizoheshin mirë këto kritere.

Në nenin 11 dhe 12 parashihen të drejtat dhe obligimet e botuesit ,porse nuk është paraparë fare mënyra e ribotimit të teksteve,të mjeteve dhe të dokumentacionit pedagogjik, që mendoj se me një nen të veçantë është dashur të parashihej për shkak të dëmtimeve gjatë përdorimit. Ribotimi i librave shkollorë dhe i liktyrave duhet të parashihen edhe nëse kanë qenë shumë të afërta dhe të përshtatshme për nxënës, si vlera pra, në kuadër të nenit të propozuar për ribotim, duhet të futet edhe paragrafi i veçantë për kompensim të autorit ,të recensuesit e tjera. Krahas kësaj dua të them se MASHT-ti me nen të veçantë parasheh lidhjen cilësore të librit me kopertina të mira dhe të forta, sepse prindërit janë të detyruar që t'i blejë edhe dy herë brenda një viti mësimor.

Në nenin 10 bëhet fjalë për lejimin e botimit të teksteve dhe të mjeteve mësimore pa tender, që vlerësohen vetëm nga juria e MASHT-it. Këto ceken në raste të veçanta(neni 5 pika 3) Një gjë e tillë mendoj se nuk është mirë,sepse tenderimi mundëson konkurrencë cilësore si

dhe nuk lejon përpilim tekstesh me nguti dhe pa kritere edukativo arsimore. Lejimi i botimit të një e më shumë dorëshkrimesh alternative, për tekstin ose për mjet të caktuar të propozuar nga anëtarët e jurisë, për çështje të zgjedhjes së lirë nga mësimmshënësit, kujtoj se është një gjë shumë e mirë dhe në zbatimin e reformës në arsim. Këtu në këtë rast, në qoftë se nuk parashihet një kriter i veçantë me ndonjë nen të veçantë për vlerësimin e alternativave si duhet, atëherë e kam një brengë se mos ndoshta kjo përzgjedhje krijon ndonjë huti në vlerësimin e nxënësve në garat e diturisë, në nivel të Kosovës dhe brenda një komune.

Në kapitullin e pestë, ku flitet për masat ndëshkimore(gjobitjen në të holla)mendoj se e risin cilësinë në përgjithësi, por edhe duhet t'i detyrojnë personin juridik dhe atë fizik që lëshimet e bëra t'i përmirësojnë sipas kritereve të përcaktuara nga MASHT-i, pa i zgjatur procedurat, për rregullimin e një materije të tillë të parashihet një nen i veçantë, ose paragraf shtesë në nenin 15.

Në fund Projektligjin e përkrahë në parim, se është shumë i rëndësishëm për arsimi e Kosovës, në këtë kohë,sepse kësi projektligji nuk e kemi pasur gjer më tani. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ragip Zekolli të përgatitet Nexhat Rexha

DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI

Zoti kryetar do të përpiqem të mos i përsëris ato që i thanë kolegët e mi parafolës, por do të përpiqem ta vë interesin e kolegëve të mi të një çështje teje e ndjeshme, kur është fjala për këtë ligj. Edhe ligji i mëparshëm është miratuar në këtë parlament. Në ligjin e mëparshëm, pikërisht për arsimin e përgjithshëm, pika 3.2 thotë se tekstet mësimore për nivelin e parë jepen falas, ndërsa tash kur po miratohet ky ligj e që ka rëndësi të madhe, nuk parashihen dispozita lehtësuese. Do të përpiqem t'jua jap vetëm një

shembull që shtetet në rajon edhe shtetet tona fqinje, duke përfshirë edhe Shqipërinë dhe Maqedoninë, literaturën shkollore, përkatësisht tekstet mësimore dhe tërë literaturën tjetër përcjellëse e kanë liruar edhe nga TVSH-eja edhe nga dogana.

Jam dëshmitar i asaj që vitin e kaluar një pjesë e librave tonë u botuan jashtë kufijve të Kosovës dhe u sollën në Kosovë, sepse kostoja e botimit ishte më e lirë, andaj kërkesa ime është që para nenin 15, po them kushtimisht 14-a mund të hyjë një dispozitë lehtësuese, në të cilën mund të thuhet se materialet shkollore, përkatësisht letra që mund të vijë në këtë rast lidhet drejtpërdrejtë me Qeverinë që duhet të sigurojë mjetet të mos të doganohet.

Një çështje tjetër, që mendoj se e ka vlerën këtu të theksohet se libri vërtetë do të vinte në duart e nxënësve është e veçantë dhe ajo mund të lidhet me një rezultat të matshëm dhe të pranueshëm ose të kapshëm edhe për mësimdhënësit edhe për nxënësit në përgjithësi. Ndërsa për sekretarin e kam një vërejtje për arsye se në rendin e ditës, në pikën 10 nuk e kanë shkruar fare lektyrën shkollore, do të thotë ne kemi biseduar disa herë, por për shkaqe parimore, do të ishte mirë sinqerisht këto gjëra të paraqiten ashtu çfarë meritojnë edhe deputetët edhe vetë Kuvendi. Ju faleminderit z. kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Urdhëroni Nexhat

DEPUTETI NEXHAT REXHA

I nderuar z. kryetarë të nderuar ministra dhe z. deputetë

Projektligji për botimin e teksteve shkollore, të mjetet mësimore, të lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogji, hynë në radhën e aktprojektligjeve të domosdoshme, sepse edhe pa të si tërësi, pjesë të këtij ligji po funksionojnë në institucionet tona shkollore. Në mënyrë praktikë, kuptohet se tani lidhet funksionaliteti i tij teorik, praktik dhe ligjor. Gjatë përpunimit të këtij projektligji kam arritur të konstatoj se ai është punuar mirë edhe pse në të nuk janë shënuar emrat e atyre ekspertëve që e hartuan tekstin e këtij projektligji. Pra këtij projektligji i mungon autorësia-çka mendoj se në të ardhmen duhet të eliminohet kjo dukuri.

Megjithatë, që ta jap kontributin tim në këtë projektligj, i kam këto vërejtje që mund të harmonizohen në punën e mëtutjeshme në komisionin përkatës, Neni 1 edhe pse nuk ka pika në vazhdim: mjetet mësimore duhet t'i shtohet edhe kjo fjali, "mjetet mësimore duhet t'i përshtaten moshës së nxënësve .kurse pesha e teksteve shkollore duhet të jetë në harmoni me moshën e tyre, vazhdon teksti më tutje.

Neni 3 pika 4, tekstit të këtij projektligji duhet t'i shtohet edhe kjo fjali, ajo duhet të jetë kapitull me vete e jo të mbetet siç është tani i përzier me pjesët e tjera të programit mësimor.

Neni 4, pika 2 këtij neni duhet t'i shtohet kjo pjesë e propozuar, paraprakisht e dëshmuar me kontributin e tyre shkencor. Nuk mund të jetë x personi ekspert vetëm se ka punuar në një fushë të caktuar, pra edhe në arsim.

Neni 6,pika 2 duhet të ndryshohet dhe të riformulohet. Propozimi im t' i dërgojnë në MASHT, kurse anëtarët e jurisë i marrin dorëshkrimet me shifra dhe pastaj u dërgohen shtëpive botuese.

Neni 8,pika 2 nuk është e qartë dhe lejon hapësirë të mjegulluar përdorimi të tekstit shkollor. Shpresoj se komisioni përkatës do të merret më hollësisht me këtë çështje, kurse neni 14,në pikën 2 kësaj pike propozoj t'i shtohet edhe kjo fjali:” Teksti i plan - programit të njësive mësimore i hartuar apo i zgjedhur nga mësimdhënësi,siç është këtu, krijon dilemë dhe propozoj që lektyrat shkollore të shpërndahen nëpër shkolla nga MASHT-i, sepse gjendja faktike sot në shkollat tona fillore dhe në të mesmet është tejet e rëndë dhe bibliotekat e shkollave kanë mbetur nën stihinë e kohës dhe të pa përgjegjësisë, pra kjo shpërndarje do të ishte mirë të rregullohej me një nen të veçantë të këtij ligji. Pra, duke pasur parasysh këto vërejtje dhe të tjerat, konsideroj se Projektligji mund të bëhet më funksional dhe më praktik pas punës së komisionit përkatës. E përkrah në parim këtë projektligj. Dhe ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ju faleminderit, lus regjinë të bëhet gati që në parim, të votojmë për miratimin e këtij projektligji, prandaj regjia të bëhet gati për votim dhe votojmë tani:

75 deputetë janë në sallë, ndërsa 91 kartela,

Për janë 72 vota
Kundër 3 vota.

Konsideroj se e miratuam Ligjin në parim. Komisionet që duhet ta shqyrtojmë punën e mëtejshme janë si vijon:

Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Teknologji
Komisioni Funksional dhe Referues,
Komisioni për Buxhet dhe
Komisioni për Komunitete.

Kalojmë në pikën e radhës

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 30.12.2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe për miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'i adresojmë për shqyrtim Komisionit funksional përgjegjës për raportin dhe komisioneve kryesore. Ftohet

ministrja Melihate Tërmkollli që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRJA MELIHATE TËRMKOLLI

Faleminderit i nderuari kryetar të nderuar deputetë.

Mungesë e aktit ligjor që do ta rregullonte fushën e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, e arsyeton rëndësinë shumë të madhe që e ka ky ligj për gjithë qytetarët e Kosovës, aq më tepër kur jemi dëshmitarë të këtyre ditëve kur po përballemi me disa raste shumë të rënda dhe aktualisht nuk ka ndonjë zgjidhje të mirëfilltë të tyre.

Projektligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë e natyrës dhe nga fatkeqësitë e tjera, siguron vendosjen e rregullave ligjore për mbrojtje dhe shpëtim të njerëzve, të pasurisë, të shtazëve, të trashëgimisë kulturore dhe të ambientit nga fatkeqësitë e natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera. Në këtë projektligj vendoset një sistem unik në fushën e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë e natyrës dhe nga të tjerat për parandalimin dhe zvogëlimin e numrit të fatkeqësive dhe për pengimin ose zvogëlimin e numrit të pasojave të tjera. Po ashtu në këtë projektligj përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe të institucioneve qeveritare të nivelit qendror dhe lokal, të ndërmarrjeve dhe të institucioneve të tjera në fushën e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, duke pasur parasysh standardet ndërkombëtare, që rregullojnë këtë fushë dhe duke respektuar të drejtat e secilit që ka nevojë për ndihmë dhe për shpëtim pa kurrfarë dallimi.

Ky ligj do të jetë i zbatueshëm për të gjitha subjektet e Kosovës, duke u nisur nga qytetarët si subjekt kryesor i organizimit të mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë e natyrës dhe nga fatkeqësitë e tjera, duke vazhduar në institucionet qeveritare qendrore dhe komunale deri te ndërmarrja dhe tek institucionet e tjera. Projektligji përbëhet nga 16 kapituj me 98 nene dhe është hartuar nga një grup i ekspertëve fushash përkatëse. Mund të them që sa u përket mjeteve financiare për zbatimin e këtij ligji, ato janë mjete që nuk mund të parashihen saktë në këtë projektligj se asnjëherë nuk mund të dimë cilat fatkeqësi mund të ndodhin dhe sa mund të jenë pasojat e tyre.

Aktualisht mekanizmat ekzistues kanë paraparë mjete për funksionim të tyre, për planin aktual buxhetor] dhe për nivelin qendror në veçanti edhe për nivelin komunal në fushën e përgatitjes për mbrojtjen nga fatkeqësitë, ndërsa Qeveria në të ardhmen nuk duhet të caktojë rezerva për raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, natyrisht se kërkon nga deputetët ta miratojë këtë projektligj në parim që ta procedojmë më tutje në Parlament. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ministre, ju faleminderit, E ka fjalën Agim Krasniqi ,lë të përgatitet Berat Luzha

DEPUTETI AGIM KRASNIQI

Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së do të jap e do të flasë shumë shkurtë lidhur me projektligjin në fjalë, projektligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Në fillim them se ky projektligj shumë është i kompletuar dhe shumë voluminoz, por nuk do të thotë që nuk ka vërejtje, nuk ka nevojë për ndryshime eventuale. Besoj që në procedurën e mëtutjeshme ky projektligj deri në finalizimin e tij, do të jetë shumë komplet dhe do të jetë shumë funksional.

Desha vetëm të ndërlihdhesha me disa nene, pa pasur qëllim që me amendamentet e këtij projektligji, por po filloj prej nenit 3 ku përkufizohen emocionet që përdoren apo nuk përdoren në këtë projektligj. Vërtet fjala është për një mocion që përmendet si mbrojtje civile, kurse në të vërtetë projektligj askund nuk përmendet, por edhe nuk ka nevojë të përmendet derisa sa nuk është në përdorim e sipër, pastaj disa nocione të tjera si p.sh. obligues i mbrojtjes nga fatkeqësitë e natyrës ose obligues i forcave nga fatkeqësitë natyrore, do të duhej të sqarohet më tepër në përmbajtjen e Projektligjit dhe se dyti do të duhej të sqarohet edhe pjesëtari i forcave të mbrojtjes që për mendimin tim nënkupton qytetarët e Kosovës që janë të sistemuar në forcat e mbrojtjes nga fatkeqësitë e natyrës.

Ka edhe nocione të tjera të pasqaruara. Mendoj se në periudhën e ardhshme në fazën e përpunimit të projektligjit do të duhej të punohet më tepër në përcaktimin e kompetencave të detyrave, të obligimeve të niveleve të ndryshme, duke filluar nga niveli qendror, nga Qeveria, nga ministritë përkatëse dhe nga niveli komunal.

Desha të them vetëm komisioni teknik këshillëdhënës është paraparë në këtë projektligj në një nen të caktuar dhe e përmendet se e kryeson dhe e udhëheq komisionin teknik këshillues, e udhëheq drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave. Deri sa Qeveria i përcakton kriteret në mënyrën e funksionimit të atij komisioni, atëherë do të duhej që ai Komision ta ketë drejtorin ose udhëheqësin e vet e jo të jetë drejtori i Departamentit për Menaxhimin me Emergjencën.

Vërejtje kam edhe për shkallën e invaliditetit ku përmendet 20% p.sh. gjatë kryerjes së detyrave të ndryshme që bëhen, kurse mendoj se nuk do të ishte kompensim adekuat ai që do të ketë vlerën kompensimi deri në 12 roga eventuale të tjera, do të duhej të kihej parasysh se ato mund të jenë afatgjata me pasoja dhe kompensimi do të duhej të kishte vlerë tjetër dhe zgjidhje tjetër. Çështje tjetër do ta përmend këtu se është edhe çështja lidhur me ndëshkimet. Po përmenda vetëm ndëshkimet ose gjobat me para. Mendoj që mund të ketë edhe ndëshkime të tjera, jo vetëm me para. Pa pasur qëllimin ta zgjatja më tepër Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah projektligjin në fjalë dhe do të angazhohet që me përpunimin e mëtutjeshëm që të jetë komplet dhe më funksional. Ju faleminderit.

KRYESUESI, GAZMEND MUHAXHERI

E ka fjalën deputeti Berat Luzha, të përgatitet deputeti Imer Halimi

DEPUTETI BERAT LUZHA

Z. kryesues, përpara kemi një projektligj shumë të rëndësishëm e të nevojshëm për Kosovën. Se sa është i nevojshëm Projektligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore tregon edhe shembja e kodrës në Grykën e Kaçanikut, që bllokoi rrugën arterien kryesore të Kosovës. Po të ishte ky ligj në fuqi ndoshta nuk do të dështonte Qeveria për zhbllokimin e rrugës, edhe pse rrëshqitja apo shembja e dheut ,sipas këtij projektligji, nuk paraqet fatkeqësi të natyrës. Madje nuk paraqet fatkeqësi fare.

Ky projektligj ka çmim të lartë buxhetor sepse me zbatimin e tij do të merren mekanizma të shumë komunave e të Qeverisë. Vetëm në nivelin qeveritar planifikohet të formohen 6, 7 mekanizma dhe shumë njësi të tjera, ndoshta jo aq shumë të nevojshëm, që do t'i kushtojnë buxhetit të Kosovës. Mekanizmi i njëjtë në nivelin komunal quhet drejtori, kurse në nivelin qeveritar quhet komunitet ndërministror,por duhet të quhet, komitet qeveritar i mbrojtjes dhe i shpëtimit. Megjithatë ligji është përgatitur mirë ,ndaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta votojë për të miratuar në parim. Ju faleminderit

KRYESUESI, GAZMEND MUHAXHERI

E ka fjalën deputeti Ymer Halimi ,të përgatitet deputeti Xhezair Murati

DEPUTETI YMER HALIMI

Ju faleminderit z. kryesues e nderuara ministre, të nderuar deputetë.

Grupi Parlamentar i AAK-së për Ligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, me vëmendje e lexon dhe e veçon. Hartuesi i saktë adreson se ky projektligj është i bazuar kryesisht në ligjin e Sllovenisë me pak ndryshime që sjellë lehtësi . Së dyti, është deklarata e ZPI-jës që me materie e këtij projektligji nuk janë rregulluar veç e veç sipas legjislacionit të BE-së,që sugjeron të rishikohet dhe të mënjanohen ndryshimet. Kjo deklaratë i referohet komunikimit ekzekutiv ndërmjet kapitullit të katërt dhe të shtatit. Së treti, Projektligji përshkruan të gjitha obligimet qytetare dhe kompetencat e Qeverisë për koordinimin e potencialit njerëzor e material për reagim në mbrojtje të jetës së njerëzve,të kafshëve dhe të mira materiale nga fatkeqësitë e natyrës dhe nga fatkeqësitë e tjera.

Përshkruan detyrimet për personat që i obligon ligji, në rastin e shfaqjes së fatkeqësive të theksuara, si edhe sanksionet ligjore për të gjithë ata që i shmangen përgjegjësisë ligjore. Përcakton detyrimet ligjore të Qeverisë për pjesëmarrësit në ndihmë dhe shpëtim, kur ata pësojnë në shëndet, humbin jetën, por dhe vlerat materiale. Lidh të gjitha levat ndërministrore e komunale për veprime në raste emergjente, por jo edhe në shkallën e duhur, parasheh një veprim të planifikuar që është shumë i mirë, për masa mbrojtëse me hulumtimet paraprake të çdo elementi paralajmërues për rrezik me kusht që Qeveria,

përkatësisht institucionet përkatëse të jenë në shkallën e duhur të përgatitjes për veprim në rast fatkeqësie.

Nenet kanë qartësi të mjaftueshme ,por me pak teprime përshkruese, gjuhësisht është i avancuar. Grupi Parlamentar i AAK-së në parim mbështetë që Projektligji të kalojë në procedim të mëtejshëm në Kuvend, por mundësisht të merren parasysh shqetësimet e ZPJ-es në masën e mundësive të Komisionit Funkcional. Ju faleminderit.

KRYESUESI, GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit.E ka fjalën deputeti Xhezair Murati, të përgatitet deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI XHEZAIR MURATI

Poštovani presedavajući, poštovana ministarko, kolege poslanici i gosti, kao što je i do sada rečeno rade se o zakonu o zaštiti od prirodnih i drugih nesreća ili nepogoda, jer se u zakonu ova dva izraza iako nisu potpuno ista dosta prepliću u vezi na srpsko – hrvatskom ili bosanskom jeziku. Ja ću ponoviti da se zaista radi o veoma bitnom zakonskom aktu koji služi zaštiti i spašavanju ljudi od prirodnih i drugih nepogoda, ja ću onda u analizi ovog zakona krenuti od deklaracije o usaglašenosti sa zakonodavstvom Evropske zajednice koju je dala kancelarija procesa evropske integracije je doslovce navela ono što ja ovom prilikom želim da podvučem, a to je da u njemu ima dosta nejasnoća koje se ogledaju u mnogim preplitanjima nadležnosti tu se posebno odnosi na poglavlje na međuministarske kompetencije ovog zakona zatim ovde se snažno preporučuje da se nacrt zakona ponovo razmtatra i da se uklone nedoumice. Ja ću navesti da u verziji jezika kojim se služim u memorandumu se radi o jednom tekstu koji ima mnogo i zaista mnogo nejasnoća tako da se gubi i smisao i sadržaj kompletno je tekst konfuzan tako da ne znamo kako je došlo do tog teksta da li se radi o prevodu ili o autorstvu jer se ne pominju uopše lica koja su radila na tom tekstu ali treba dijametralno dakle potpuno izmeniti tekst memorandumu ovog zakona. Oni koji bolje razumeju jezik ja preporučujem, govorim o verziji jezika koji govorim. Mislím da je malo razvučen u nekim segmentima i da može biti malo sažimanja ono što je i ministarka rekla, dakle 16 poglavlja, 95 članova tu može jer ima nekih preplitanja u sadržaju pojedinih članova zakona. Ja bih se takođe zadržao na poglavlje 12. gde se predviđaju posebni uslovi rada i to računajući i uzimajući u obzir mentalitet naroda koji žive u ovoj našoj sredini pa i šire govori se ovde o radu nedeljom, radu za vreme praznika kao i o radu vanredovnih rasporeda, dežurstva itd, dakle tu treba još neke stvari precizirati jer veoma često svi smo zaduženi a ispada da niko nije zadužen a kao što ste i sami rekli nemoguće je predvideti finansijsku podlogu za ovaj zakon , jer nikad ne znamo šta može da se dogodi, međutim nemoguće je predvideti i posebne uslove rada i zato ih treba u zakonu precizirati. Ja ću zaključiti PG 6+ mi smo se detaljniji pozabavili ovim zakonom i želim da podvučem da treba u verziji na srpsko – hrvatskom ili bosanskom potpuno izmeniti memorandum, jer je on totalno ne odgovara i posvetiti veću pažnju o poglavljima o kojima sam govorio, mi smo ipak dali neku jedva prelaznu ocenu ipak se radi o veoma veoma značajnom zakonu

jer smo i danas govorili o nekim nepogodama koje nas pogađaju ili ne daj Bože koje mogu da se dese. Hvala

KRYESUESI, GAZMEND MUHAXHERI

E ka fjalën deputeti Ramadan Kelmendi, të përgatitet deputeti Fadil Geci

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI

I nderuari kryesues, të nderuar kolegë deputetë, e nderuara ministre dhe të pranishëm

Është evidente se në Kosovë mungon ligji adekuat, me të cilin rregullohet mbrojtja nga fatkeqësitë e natyrës dhe fatkeqësitë e tjera. Kjo shtron domosdoshmërinë dhe arsyen shumë të nevojshme që ta kemi këtë propozim ligj, që për analizën dhe konceptin tim është hartuar mirë dhe e përkrah në parim për miratim. Ndonëse kjo është esenca e diskutimit tim, më lejoni që në masë të nevojshme t'i shtroj edhe disa çështje të hapura që lënë vend për rregullim dhe saktësim juridik të disa çështjeve konkrete.

Së pari duhet të përcaktohet se mbrojtja nga fatkeqësitë e natyrës duhet të kuptohet ose të nënkuptohet si masë mbrojtëse para se të ndodhin fatkeqësi natyrore ose si masë për eliminimin e pasojave pasi të ketë ndodhur fatkeqësia natyrore. Nga emërtimi dhe qëllimi i propozim ligjit nuk rezulton përcaktimi i drejtë dhe i qartë në këtë drejtim.

2. Nuk përcaktohen fatkeqësitë e tjera natyrore njerëzore,ose ndonjë formë tjetër fatkeqësish të shumta por edhe në pamundësi mbrojtjeje në mundësi sanimi të atyre pasojave për të cilat ligji krijon mundësi.

3. Këto vlerësime analizuese rezultojnë qartë se emërtimi i propozim ligjit është adekuatë dhe në pajtueshmëri me qëllimin dhe me përmbajtjen që e ka shtruar.

4. Vlerësoj se mbrojtja më e mirë nga fatkeqësitë e natyrës është të merren masa paraprake preventive, lidhur me fatkeqësitë natyrore dhe të njohura deri më tani në këtë hapësirë territoriale,përkatesisht në këtë hapësirë gjeografike të Kosovës.

5. Duke përcaktuar kornizën ligjore për mbrojtjen nga fatkeqësitë e natyrës, propozim ligji le hapësirë për çështje të pa përfshira dhe të trajtuara jo si fatkeqësi natyrore, si p.sh. ndotjet e ambientit natyror, ndotjet nga lumenjtë, dhe masat e tjera kimike e tj., pa i përcaktuar as masat parandaluese në rastin konkret. Norma ligjore, duke përcaktuar mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore nuk përcakton as mbrojtjen e të drejtave të viktimave dhe të pasurisë së tyre në fatkeqësi eventuale, ndonëse këtë e shtron si mundësi dhe e elaboron si një pjesë dhe faktin se mossanimi dhe mos rregullimi unik i mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore, sepse për punëtorët e angazhuar në mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore vlejné rregullat e punës si për për nëpunësit civilë, që nuk është e drejtë, sepse diametralisht punët e tyre ndryshojnë për nga shkalla e rrezikshmërisë dhe e angazhimit në mbrojtje nga fatkeqësitë.

Vlerësoj se Qeveria, si pushtet qendror dhe komuna- si pushtet vendor - duhet të kenë programe të qarta dhe kompetenca të përcaktuara në mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, po qe se dëshirojmë t'i përcaktojmë përgjegjësitë në dështimet eventuale apo aspektin territorial dhe në atë të kompetencave në mbrojtje nga fatkeqësitë.

Në rrethana ekzistuese kategorizimi i furnizimit, po e marrë shembull vetëm furnizimin me energji elektrike në fatkeqësitë e tjera do të shkaktonte probleme shumë të mëdha, mobilizim të përgjithshëm etj. Këtu, në Kosovë, nuk ndodhin këto, natyrisht dihet, por kjo nuk do të thotë se nuk ndodhin kurrë dhe lenë kuptime se propozim ligji është i përkthyer nga ndonjë ligj që vërtet këtë çështje e ka të rregulluar më mirë se ne, por duke përcaktuar krijon obligime.

Neni 51, kërkon analizë më të thuktë dhe më të thellë: a duhet të inkorporohet në këtë propozim ligji mbrojtja e trashëgimisë kulturore ose mos mbrojtja, sa do të shkaktohen probleme të shpenzimeve. Ta marrim si shembull pamundësinë e funksionalizimit të komplekseve të ndryshme, të monumenteve kulturore historike të traditës, të kulturës, të fesë e tjera. Një rast i tillë që është i hapur, por që nuk duhet të elaborohet gjerësisht, këtu është problemi që tani ka lindur: funksionalizimi i kompleksit të kullave të Isa Buletinit se po të ishte ky ligj në fuqi, do të zbatohet por do të krijonte probleme jashtëzakonisht të mëdha.

Vlerësoj se me Ligjin e miratuar në këtë Kuvend, do të krijohet mundësi të formimit të komiteteve, bordeve e të agjencive, pa i i përcaktuar sa duhet kompetencat, organet, funksionalizimet dhe burimet financiare, duke krijuar probleme të pastajme që do të rezultojnë pas fazës kur do të zbatohet ky ligj Andaj, për nxjerrë akte nënligjore nuk duhet të jetë një vit, por 6 muaj pas nënshkrimit të këtij ligji, sepse pas një viti vërtetë është afat i gjatë që të funksionojë dhe të fillojë zbatimi i drejtëpërsëdrejtë i ligjit. Vlerësoj se ky propozim ligj në tërësi meriton të përkrahet në parim dhe të begatohet në procedurën e mëtutjeshme në Komisionin Funksional. Edhe një herë konfirmoj përkrahjen për miratim. Ju jam mirënjohës për vëmendjen. Ju faleminderit.

KRESUESI, GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit .E ka fjalën deputeti Fadil Geci , të përgatitet Hydajet Hyseni- Kaloshi

DEPUTETI FADIL GECI

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë, e nderuara ministre.

Projektligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, është një dokument i rëndësishëm juridik që ka munguar deri më tash në fushën legjislative të Kosovës. Ky projektligj në një shkallë deri dikur të lartë juridike i rregullon çështjet e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, për të gjithë banorët e Kosovës. Tash kur po bëhen gati 7 vjet pas përfundimit të luftës në

Kosovë, ruajtja dhe mbrojtja e popullit të Kosovës dhe e pasurive shtetërore e private të Kosovës, nga fatkeqësitë elementare të natyrës duhet të jetë preokupim i institucioneve të mekanizmave mbrojtës, duke filluar nga niveli lokal deri te ai qendror. Populli i Kosovës dhe pasuria private dhe ajo shtetërore duhet të mbrohen me ligj, jo vetëm nga ndonjë agresion i jashtëm shtetëror se nga grupe terroriste, por edhe nga fatkeqësitë eventuale natyrore që mund të ndodhin në Kosovën e pa luftës, prandaj nxjerrja dhe miratimi i një akti të tillë ligjor janë domosdoshmëri për popullin e Kosovës dhe për pasuritë shtetërore dhe private të saj.

Ky ligj, gjithashtu, obligon pjesën dërrmuese të Kosovës si dhe institucionet lokale e qendrore të saj, që të dalin në ndihmë dhe ta japin kontributin e tyre në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore ose fatkeqësive tjera në ndonjë lokalitet ose territor të caktuar të Kosovës. Nga praktika e përditshme jemi dëshmitarë së paraqitjes së pa prituri të fatkeqësive natyrore në Kosovë, kemi pasur si dridhje të tokës, vërshime, zjarre. ndeshje të rënda të komunikimit. Para dy vjetësh ishte rasti i Gjilanit, ndërkohë që nuk kanë munguar as vërshimet, as zjarret as edhe ndeshjet të rënda të komunikacionit. Meqenëse në raste të tilla nuk munguan gatishmëria dhe ndihma konkrete e institucioneve lokale, as e atyre qendrore të Kosovës, posaçërisht e Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe e Shërbimit Policor të Kosovës rregullimi ligjor i kësaj fushe të mbrojtjes do të ngrit edhe më shumë gatishmërinë e përgjithshme dhe do t'i zvogëlojë fort edhe pasojat e fatkeqësive natyrore.

Të nderuar kolegë deputetë, Projektligji për mbrojtjet nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, si shihet është punuar nga një grup ekspertësh, qoftë vendorë, qoftë ndërkombëtar dhe si të tillë ky projektligj është në harmoni me standardet legjislativë evropiane të kësaj fushe mbrojtëse. Në 16 kapituj dhe 98 nene e Projektligji janë rregulluar po thuajse të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë problematikë të mbrojtjes nga fatkeqësitë e natyrës dhe fatkeqësitë e tjera.

Duhet përmendur në këtë rast se ky projektligj në shikim të parë duket i ngarkuar me kapituj dhe nene, si dhe me fjali të gjata dhe me përshkrime të tepërta verbale. Gjithashtu gjatë formatizimit të tij janë përvjedhur disa gabime drejtshkrimore siç është rasti në renditjen e numrave rendorë romakë. Por çështje tjetër, që duhet të përmendet në këtë rast, është referenca legjislativë e këtij projektligji. Ne e dimë se ky projektligj është sponsoruar nga Ministria e Shërbimeve Publike, por tash jemi në kohën e krijimit edhe të ministrive të tjera dhe kjo fushë e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, si dhe gjithë Departamenti për Gatishmëri Emergjente, sigurisht do të kalojë në kompetencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Prandaj, është mirë që gjatë shqyrtimit të Projektligjit në komisione të Kuvendit, nenet që i referohen Ministrisë së Shërbimeve Publike të zëvendësohen me ministrinë përkatëse, përpos se do të kalojë nëpër duart e anëtarëve të Komisionit të Kuvendit të Kosovës për Gatishmëri dhe Emergjencë si dhe në komisione të tjera të Kuvendit, sigurisht se do të marrë formë më të përkryer përmbajtësore dhe gjuhësore si do qoftë. Projektligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera është një bazë e mirë ligjore që mund të procedohet më tutje nga Kuvendi i Kosovës. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI

E ka fjalën deputeti Hydajet Hyseni , të përgatitet deputetja Qibrje Hoxha

DEPUTETI HYDAJET HYSENI- KALOSHI

Ju faleminderit z. kryesues, duke ju përshëndetur të gjithëve, më lejoni që ta përshëndes nismën për miratimin e këtij ligji dhe të mbështes tekstin e ofruar të ligjit. Kosova ka pasur nevojë për të rregulluar me ligj edhe këtë fushë. Besoj se efektet e këtij ligji do të jenë pozitive parandaluese dhe do të dëshiroja që pasojat e fatkeqësive të jenë minimale . Por megjithatë edhe këtij ligji mund t'i bëhen vërejtje. Unë do të përqendrohem vetëm në dy prej tyre. E para që lidhet edhe me debatin në disa pika të mëparshme të rendit të ditës me teknikën dhe me metodologjinë e standardizuar që duhet ta respektojë çdo ligj dhe kjo le të jetë vërejtje për Zyrën ligjore të Qeverisë. Një pjesë e tha kolegu për shkresën përcjellëse, nuk është në rregull që secili ligj të ketë formë krejt tjetër, por do të dëshiroja ta them edhe një vërejtje pak më duket vogëlim. Ligji në gjuhën shqipe ka titullin **ligjin**, porse do të duhej të praktikohet gjithmonë, propozon këtë, dhe titulli të jetë ligj, si është në gjitha gjuhët dhe në shumicën e ligjeve. Por vërejtja ime përmbajtësore,në përputhje edhe me natyrën e këtij debati, mendoj se duhet të tërheqë më shumë vëmendjen në shqyrtimin e mëtejshëm në komisionin përkatës funksional lidhur me menaxhimin e situatave të fatkeqësive natyrore.

Kolegë deputetë, ju siç e dini fatkeqësitë natyrore janë mjegullnajë shumë e përshtatshme për ujqit e pangopshëm, të rafinuar të keqpërdorimeve , të ndryshme financiare e materiale. Ligji ynë në kreun 14 vetëm kalimthi ka përmendur çështjen e financimit dhe të menaxhimit të duhur financiar të situatave të këtilla. Si ilustrim do të përmendja përvojën tonë të freskët me tërmetin e Gjilanit,Zonja dhe zotërinj edhe 6 vjet pas këtij tërmeti një pjesë e madhe e familjeve të dëmtuara edhe sot janë pa strehë. Kuvendi i ndau 5 milion dhe ndikoi të ndahen 5 milionë për eliminimin e pasojave të tërmetit, vetëm një e treta e tyre janë dërguar në destinim , pjesa më e madhe e mjeteve u shpenzua për ndërtimin e rrugëve,kanalizime dhe për përfitime të ndryshme edhe politike edhe materiale etj. Është një shembull që mendoj se nuk duhet të lejohet më në të ardhmen në Kosovë, prandaj edhe apeloj që gjatë shqyrtimit të mëtejshëm të plotësohet kreu i 14, të sigurohen më shumë mundësi institucionale për transparencë për mbikëqyrje parlamentare dhe shoqërore në këtë fushë të rëndësishme ,për të mos lejuar situata të ngjashme edhe në të ardhmen. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI

E ka fjalën deputetja Qibrje Hoxha , të përgatitet deputeti Ibush Jonuzi

DEPUTETJA QIBRIJE HOXHA

Ju faleminderit z. kryesues. Ky projektligj për mbrojtje nga fatkeqësitë e natyrës dhe nga fatkeqësitë e tjera përmbajtësish është hartuar shumë mirë dhe për këtë mendoj se duhet të miratohet në parim.

Dëshiroj të jap një sugjerim rreth këtij projektligji. Unë nuk jam juriste por për këto sugjerime mbështetem në ligje të disa vendeve të Organizatës për Emergjencë dhe Shpëtim që vepron në kuadër të NATO-s ,ku Kosova merr pjesë si vëzhguese.

Bëhet fjalë për kapitullin e tretë që është paraparë me këtë projektligj dhe ka të bëjë me të drejtat dhe obligimet e qytetarëve në rast të fatkeqësive natyrore, ose të fatkeqësive të tjera. Sipas mendimit tim do të duhej të ishte ndarë në tre kapituj të tjerë që përcillet me nene përkatëse. Kapitulli i parë do t'i përcaktonte obligimet dhe të drejtat e qytetarëve në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore ose fatkeqësie tjetër, ndërsa kapitulli tjetër, i dyti, i veçantë do të përcaktonte obligimet e komunave në rast të fatkeqësive që mund të ndodhin, si dhe në parandalimin e tyre. Këtë e them për arsye se komunat tona e kanë të rregulluar vetëm organizimin në fushën e mbrojtjes së qytetarëve në shtabe gatishmërie dhe emergjencë në kuadër të drejtorive dhe të komisioneve përkatëse ,d.m.th. se komunat tona vetëm funksionojnë si të pavarura në këtë aspekt.

Kapitulli i tretë do të mund të ishte një kapitull që do të përcaktonte obligimin e mbrojtjes së qytetarëve nga fatkeqësitë eventuale në nivel nacional. Në këtë drejtim mendoj se formimi i komitetit ndërministror të mbrojtjes dhe të shpëtimit të paraparë me këtë projektligj është i qëlluar dhe si i tillë do të kontribuonte në plotësimi e nevojave emergjente të kësaj natyre. Mendoj se sikur edhe parafolësit e mi ta kishim këtë ligj bazik do të mund t'i përballonin më lehtë situatat emergjente që na u krijuan javëve të fundit me shembjen e dheut në pjesën e magjstralit Kaçanik – Shkup. Edhe vërshimet që kanë përfshirë këto ditë një pjesë të madhe të Kosovës. Përfundimisht ndarja e këtillë obligimeve me ligj ,që i përmenda në rast të fatkeqësish natyrore dhe të fatkeqësive të tjera është e dobishme, jo vetëm në aspektin humanitar, por edhe në funksionimin demokratik dhe institucional të shoqërisë në përgjithësi. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI

E ka fjalën deputeti Ibush Jonuzi dhe i fundit Behxhet Brajshori

DEPUTETI IBUSH JONUZI

Z. kryesues, e nderuara ministre, deputetë të respektuar. Projektligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera , që tani po e shqyrtojmë në parim,është fushë shumë me rëndësi, por është edhe shumë e ndjeshme, prandaj me miratimin e këtij projektligji krijohen mundësi më të mira që në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësish të tjera, të veprohet sipas ligjit. Veprimet duhet të jenë më të shpejta plotësisht zyrtare dhe duhet të jenë më të efektshme,. Projektligji është i hartuar mirë dhe i plotëson kushtet të miratohet në parim, ndërkaq unë do të ndalem vetëm në dy raste konkrete që mendoj se duhet të përpunohen gjatë punës së mëtutjeshme të projektligjit.

Neni 27 pika 1, drejtuesi i operacionit, komandanti i incidentit caktohet në rast të fatkeqësive natyrore ose është funksion i përhershëm. Nëse është post i përhershëm, cilat janë detyrat e tij të saktësuara si duhet, pos tjerash mendoj se detyra atastaj neni

65.1 detyrat e komandantit të incidentit nuk janë të saktësuar si duhet, pos tjerash mendoj që detyrat e komandantit të jenë si vijon:

1. Ta rregullojë dhe ta mbështetë sistemin e zakonshëm të menaxhimit,
2. Ta standardizojë menaxhimin e komunikimeve dhe të informacioneve,
3. T'i sigurojë të dhëna të përhershme për sistemin në përgjithësi,
4. T'i përshkruajë procedurat e komunikimit,
5. T'i përgatitë dhe t'i trajnojë anëtarët e postëkomandave të incidentit dhe t'i sigurojë resurset e sofistikuara për menaxhimin e emergjencave,
6. Ta formojë një ekip të përhershëm profesional që të merret me menaxhimin e emergjencave dhe
7. Të përkujdeset për gjërat më të rëndësishme të furnizimit.

Në parim e mbështet Projektligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë e natyrës dhe nga fatkeqësitë e tjera, Ju faleminderit.

KRYETARI IKUVENDIT NEXHAT DACI

Ibush ju faleminderit edhe Behxhet Brajshori

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI

Z. kryetar, ministra të nderuar, kolegë, deputetë

Duke i mbështetur parafolësit për atë që shtruan, do të ndalem pak a shumë te financimi. E di se është një ligj që vërtet ka implikime buxhetore, por mendoj se në këtë drejtim ne nuk duhet kursyer. Pikërisht për këtë unë mendoj se me ligj duhet sanksionuar se cili fond rezervash vjetore, madje nuk mund të parashihet- ndoshta- sa do të jetë kapaciteti i një fatkeqësie natyrore, por sidokudo shteti duhet të ketë të vetin një fond rezervë. Unë mendoj se këtu duhet të depozitohet një përqindje në buxhetin total që gjithmonë do të ishte rezervë, edhe në nivelin qendror, pra edhe komuna duhet ta ketë të njëjtën gjë, që do të bënte të mundshme të mos humbet kohë në rast fatkeqësie në procedura vendimmarrjeje për mbulimin e atyre shpenzimeve që do të shkaktoheshin.

Neni 72, ndoshta ka pak a shumë për mua është e tepërt, sepse parasheh se planet e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera t'i miratojë Kuvendi i Kosovës, por ndoshta do të ishte më mirë sikur këto të mbeten në nivelin e Qeverisë, sepse kemi njësi përkatëse edhe ato do të bënin programe miratimi dhe implementimi të asaj që do ta shkaktonin fatkeqësitë natyrore. E mbështes projektligjin dhe do të japim kontributin tonë këto ditë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Behxhet ju faleminderit, e ftojë regjinë të përgatitet që ta mbështesim në parim Projektligjin e debatuar,. Bëhemi dhe votojmë tani:

Për janë..... 77 vota
Kundër 2 vota

Konsideroj që Projektligji u miratua në parim. Komisionet duhet ta marrim përpunimin e mëtutjeshëm,

Komisioni për Gatishmëri dhe Emergjencë si Komision FunkSIONAL dhe Referues,
Komisioni për Gjyqësi,
Komisioni për Buxhet dhe
Komisioni për Komunitete.

Dhe kalojmë në pikën e parafundit,

Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Kuvendi i Kosovës në disa mbledhje radhazi i ka shqyrtuar kërkesën e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe listën e të nominuarve nga institucionet e përcaktuara me ligj, që duhet të plotësohet edhe me tre përfaqësues të emëruar nga Kuvendi. Kjo çështje ishte temë debati edhe në seancën e kaluar ,që vendosi të shtyhej miratimi të për seancën e radhës, me qëllim që të sigurohet marrëveshja e grupeve parlamentare për propozimin e 3 anëtarëve nga radhët e Kuvendit.

Propozimi i Qeverisë, bashkë me të dhënat biografike të kandidatëve të dominuar u janë shpërndarë me kohë të gjithë deputetëve. Nuk kemi ndonjë njohuri për marrëveshjen eventuale të grupeve parlamentare, megjithatë, Kuvendit i kanë arritur propozimet e veçanta nga disa prej grupeve parlamentare si vijon:

Grupi Parlamentar i LDK-së Sadudin Berisha

Grupi Parlamentar i PDK- Gani Koci

Grupi Parlamentar i AAK-së Ymer Halimi. Nga Partia Demokratike Serbe si pjesë e Grupit Parlamentar të komunitetit Sasha Gjokiq.

Nga Grupi Parlamentar për Integrim Ferid Agani, do të thotë prej këtyre pesëve duhet tre, duhet të jenë të zgjedhur, Nuk do të kisha kërkuar debat më, vetëm propozime në qoftë se ka konkrete. Nëse jo jo të hyjmë në votim dhe ta kryejmë këtë çështje,. Edhe në Kryesi është marrë i njëjti qëndrim njëzëri pa asnjë mendim tjetër. Seanca duhet të dalë në fund të kësaj çështjeje Nekibe a ke ndonjë propozim si avokate jo si deputete të na ndihmosh.

Grupi Parlamentar i LDK-së prioritet të jetë Sadudin Berisha. Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani. Kush është për këtë kandidat?:

Për janë56 vota
Kundër..... 20 vota

Konsideroj se Sadudin Berisha ka kaluar si kandidatë,

Nga PDK-ja është Gani Koci, regjia përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani

Për janë42 vota

Kundër..... 37 vota

Konsiderojë që ka kaluar kandidati

Nga Grupi Parlamentar AAK- Ymer Halimi. Regjia bëhuni gati për të votuar, votojmë tani:

Për janë.....61 vota

Kundër 17 vota

Konsideroj se edhe Ymer Halimi ka kaluar, prandaj mendojmë se ne tre i kemi zgjedhur.

Ju lutem vini re, sipas propozimit të procedurave tash e kemi listën në tërësi, duhet ta miratojmë, listën në tërësi të propozuar nga Qeveria,

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ

Z. kryetar duhet të votojmë për pesë kandidatë. Ata që marrin vota më shumë se tre të parët, d.m.th. duhet të konsiderohet se janë zgjedhur, kështu që mos t'i diskriminojmë dy kandidatët e tjerë, mendoj se duhet të vazhdojë votimin.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Gjergj ,zu të më pëlqente propozimi yt, por në krah të djathtë po thotë pa objekt është ajo, prandaj duhet t'i dëgjoj njerëzit që janë të paguar për këtë punë, ju lutem në qoftë se kemi bërë ndonjë gabim lejohet të intervenohet, j këto janë kandidatët që duhet në tërësi t'i votojmë, prej subjekteve të ndryshme.

Z. Adem Logjaj, Zyra e presidentit të Kosovës,

Z. Habit Hajredini- Qeveria e Kosovës

Fejzullah Hasani, Gjykata Supreme e Kosovës

Besim Kelmendi -Prokuria Publike e Kosovës

Ragip Gajraku, autoritetet lokale, asociacioni i komunave të Kosovës dhe

Bashkim Rahmani, Shoqëria civile, Fondacioni për Iniciativë Demokratike FDI, prandaj regjia bëhuni gati për t'i votuar ju lutem dhe votojmë tani:

Për janë..... 44 vota

Kundër..... 35 vota

Konsiderojë se është votuar edhe ky propozim dhe kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës, është pika e 13.

13. Propozimi i Kryesisë së Kuvendit për rendin e ditës të seancën plenare të 16 marsit

Besoj së deputetët e kanë propozimin, ka ardhur një kërkesë shtojcë nga kryetari i Grupit Parlamentar për Integrim dr. Ferid Agani, për ta vënë në rend të ditës të pikës.

Emërimi i anëtarëve të Grupit Parlamentar për Integrim në komisionet parlamentare. Ju lutem ,duhet t'ju them që e kemi pasur dy herë në Kryesi këtë çështje, do të thotë që nuk është shqyrtuar, Kryesia ka qenë unanime, do të thotë të gjithë të pranishmit në një mendim që të kërkohet ndihmë nga strukturat që kanë ndihmuar për krijimin e komisioneve parlamentare, do të thotë formula që është aty dhe sipas atij propozimi ishte edhe lutja ime që e kam përkrahur të gjendej mundësi të ndërlidheshim ,do të thotë se nuk ka pasur refuzim. Feridi është duke na e sqaruar çka dëshiron, seanca nuk mund të marrë vendim pa propozime, prandaj urdhëroni Ferid,

DEPUTETI FERID AGANI

Ju faleminderit z. kryetar, kërkesa është vetëm që kjo pikë e rendit të ditës të futet në rend të ditës të seancës së 16 marsit. Në ndërkohë Kryesia të marrë vendim për t'i propozuar seancën plenare që anëtarët e Grupit Parlamentar për Integrim të emërohen nëpër komisione parlamentare sipas propozimit që e kemi bërë. Mendoj se rregulla 41 e Rregullores së Kuvendit e përcakton se për strukturën e komisioneve vendos Kuvendi dhe nuk ka kurrfarë kufizimesh në atë aspekt, do të thotë për numrin e anëtarëve për komisione parlamentare vendos Kuvendi dhe nuk ka kufizime të numrave, për pos për Komisionin për Buxhet, në të cilin me Kornizë Kushtetuese është i përcaktuar numri prej 12 anëtarëve. Mendoj se tre muaj pas themelimit të Grupit Parlamentar për Integrim dhe pas dy kërkesave të parashtruara të Kryesisë ekziston baza që Kryesia për seancën e ardhshme, më 16 mars t'i a propozon seancën plenare miratimin e kandidatëve tanë. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ferid, krejt atë që e thatë është e saktë, por kryesoren nuk e përmendët. Besoj që e dini shumë mirë. Kryesia në dy takime nuk arriti të gjendet formulë, që nuk i prish raportet e ekzistuese për një vit. Kryesia nuk është kundër që të ndërlidhemi, por duhet që të gjendet një formula. Kuvendi nuk mund të nxjerrë formulë pa e dhënë asnjë propozim profesional politik të dikujt. Kemi kërkuar ndihmë jashtë Kryesisë dhe në momentin që të na ofrohet kjo ekziston gatishmëri e plotë në Kryesi që ta vendosim dhe seanca vetëm formalisht pastaj- se seanca nuk debaton për kandidatë; kjo është esenca,. Edhe ju ndihmona me strukturat që komunikoni cilat t'i propozojmë do të ishte në rregull, prandaj ju falënderoj. Urdhëroni Gjylnaze Syla

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

Ju faleminderit z. kryetar, desha vetëm t'ua kujtoj Kuvendit që në seancën plenare të 17 dhe 19 nëntorit , me iniciativën e grupit parlamentar është miratuar të fillojë draftimi i

Kushtetutës së Kosovës, por faktikisht puna s'ka filluar ende, prandaj Grupi Parlamentar i AAK-së që në seancën e 16 marsit kërkon t'i jepet autorizim Komisionit dhe të gjithë të tjerët që mund të ndihmojnë në draftin e Kushtetutës së Kosovës, sepse duhet të fillojë pasi ne po përgatitemi se Kushtetuta duhet të jetë e gatshme atëherë edhe kur të shpallet qëllimi ynë- Pavarësia e Kosovës,-duhet të jetë gati. Tani aranzhimet kushtetuese,por meqenëse është një punë serioze konsideroj se duhet të fillojë sa më parë. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Gjylnaze, një paqartësi. Kërkesa është shtruar me kohë dhe është me vend, propozimi nuk besoj se do t'ju kalojë. Komisioni për Legjislacion nuk është komision që do të merret me çështje, as nuk do të jetë komisioni që e ka formuar Delegacioni i Kosovës, po e them këtë se e kam lexuar dhe e përcjell shtypin, do të thotë kjo seancë do të caktojë komision të veçantë dhe do të mëremi vesh cila do të jetë struktura më prezantuese në të gjitha aspektet dhe kjo do të jetë seancë që do ta përcaktojë. Jakup Krasniqi urdhëro

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

Z. kryetar në fillim të seancës kam bërë dy kërkesa që me procedurë të ngutshme të futen në rend të ditës, çështja e vërejtjeve që vijnë nga komuniteti ndërkombëtar për standardet, mendojmë se është çështje shumë e ngutshme, sepse standardet lidhen edhe me statusin politik të Kosovës. Mendojmë që kjo çështje duhet të bëhet në seancë sa më parë, ndoshta para seancës së marsit që është caktuar dhe për këtë Kryesia duhet ta marrë obligimin që të kërkojë nga kryeministri të na njoftojë në Kuvend se si është gjendja e standardeve dhe si po plotësohen ato.

1. Përsëri mendojmë se çështja e privatizimit ka hyrë në një fazë të tillë, thuajse përfundimtare , mendojmë që duhet të debatohet seriozisht në Parlament ,sepse është çështje e ngutshme për shumë arsye, por mendoj për arsye që Qeveria dhe ky Parlament duhet të caktojë a ka pasuri kombëtare në Kosovë dhe cila është ajo. Mendoj që është momenti i fundit për ta bërë këtë, prandaj, do të ishte mirë që për këtë çështje Qeveria në bashkëpunim me AKM-në dhe me bordin e AKM-së ta hartojnë një raport dhe të debatojmë e të caktojme vërtet cila pasuri në Kosovë nuk do të duhej të privatizohej edhe për një arsye tjetër. Rreth Feronikelit ka pasur shumë shkelje të procedurave, zakonisht shkeljet e procedurave nuk bëhen pa ndonjë arsye dhe mendojmë që edhe kjo çështje duhet të ndërpritet dhe Feronikeli dhe minierat e tjera të shpallen pasuri kombëtare e Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Jakup, për freskim të kujtesës, një herë më duket se Parlamenti ka debatuar për standarde pa rezultat. Më duket se nuk jam i sigurt,prandaj të pyeta, se sa më kujtohet mua e kemi pasur një debat, nuk e di në këtë apo në atë mandat dhe për privatizimin po ashtu një kujtesë diku kemi debatuar, kurrsesi nuk po them jo, Mendoj që ky propozim të vijë në Kryesi, kurse ajo le të kërkojë nga Qeveria këtë që po kërkohet, në mënyrë që debati

të ketë dobi jo vetëm të flasim 5 orë dhe asgjë. Të dy këto çështje-edhe privatizimi edhe standardet- janë fundamentale, do të thotë për to jemi ne, por në qoftë se ne vijmë vetëm si në seancë plenare si deputetë dhe debatojmë është në rregull, prandaj po ju them se ne do ta kemi një seancë të Kryesisë për programin e ri të punëve dhe ndoshta do të kemi seancë që do ta ketë vetëm privatizimin ose vetëm standardet. Çdo javë do të jenë seancat plenare për të qenë më të efektshme, për të pasur rezultate,duhet të jemi të përgatitur, do të thotë në parim po e marrim propozimi tuaj shumë seriozisht ,sepse ka qenë disa herë, por nuk mund të vendosim tash. Nuk po e shoh të arsyeshëm këtë , sepse vetëm e vendos. Urdhëro Sabri Hamiti

DEPUTETI SABRI HAMITI

Z. kryetar desha t'i them dy tri fjalë lidhur me propozimet e PDK-së që po i bënë shefi i grupit të tyre. Propozimet e kanë logjikën e vet edhe politike edhe kuvendore, aty vërejtje nuk mund të bëhen, por mënyra si Krasniqi i paraqet këto janë dy nivele krejt ndryshe, është nivel krejt tjetër të bisedohet për standardet si norma që kapin mbarë veprimin politik e qeveritar të Kosovës, por tjetër është të bisedohet për privatizimin - konkretisht për Feronikelin, janë dy probleme shumë të ndryshme. Nëse bëhet e para kërkohet, mendoj që duhet ta kërkojmë të gjithë së bashku dhe të përgatitet Qeveria e të japë raport me të gjitha ministrinë e veta para Kuvendit .Kjo duhet të bëhet vetëm ashtu, sepse çdo segment i veçantë nuk mund të bëhet, ndërsa sa i përket problemit të privatizimit dhe konkretisht Feronikelit, sot bisedova konkretisht me Dugollin, por nëse ministri i resorit të veçantë është i gatshëm dhe mezi pret të thirret në interpelancë në Kuvend për një problem , nuk shoh arsye pse të mos thirret dhe PDK-ja mund ta thërrasë në interpelancë edhe Rukerin. Ai thotë se vjen edhe ai, por nuk thotë se nuk kemi fuqi ta biem , por Dugollin ne kemi fuqi dhe nëse PDK-ja kërkon që ministri i resorit të vij,pse të mos vij në interpelancë në mbledhjen e ardhshme. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

Ne vërtet mund ta bëjmë këtë si grup parlamentar me nënshkrime, por kam konsideruar dhe konsideroj ende se edhe njëra edhe çështja tjetër nuk janë fjalë vetëm për Feronikelin. E kemi të qartë edhe për minierat, por edhe çka tjetër është pasuri kombëtare e Kosovës. Mirëpo kam dëshiruar dhe kërkesën e kamë bërë këtu që të vendosë Parlamenti dhe gjitha grupet parlamentare. Kjo ka qenë ideja ime, sa i përket interpelancës ne i kemi bërë dy kërkesa për interpelancë, por kryeministri dhe ministri nuk janë përgjigjur.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Edhe një herë edhe Sabriut edhe Jakupit, u them se është detyrë e Kryesisë që prapë të bëhen këto propozime. Hydajet urdhëro.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

Faleminderit z. kryetar, megjithatë e kam një lutje, mos ma përmendi shpesh emrin se tani po bëj replika dhe ligjërata, nuk po më pëlqen, lidhur me rendin e ditës të mbledhjes së ardhshme dëshiroj ta shtroj edhe një herë çështjen e pyetjeve parlamentare që presin përgjigje dhe duam që të insistojmë për një raport adekuat midis ekzekutivit dhe deputetëve për këtë çështje, se mos respektimi i pyetjeve të deputetëve flet keq për ministrat tanë, dhe çështja e dytë cilën që desha ta shtrojë z. kryetar me lejen tuaj, jo si replikë, por për të mos dalë të pa qartë nga ky Kuvend që u përmend edhe çështja e Kushtetutës dhe e raportit me Komisionin, kisha përshtypje se përgjigjja që dhatë ishte një farë mënyrë shumë arbitrare dhe prejudikuese, mund të vendoset ashtu por le t'ia lëmë Kuvendit të vendosë.

Komisioni për Çështje Legjislative, Gjyqësore dhe Kushtetuese, asnjëherë nuk ka insistuar që kësaj qasjeje t'i afrohet ekskluzivisht vetë, gjithmonë kemi pasur qëndrim që e kemi futur edhe në programin tonë, se komisioni duhet të jetë bartës i këtij procesi, por natyrisht do ta bëjë bashkërisht me institucionet e tjera. Kështu e kemi interpretuar z. kryetar, por ju mund ta interpretoni edhe ndryshe, le të vendos Kuvendi, por mendoj se duhet ta ruajmë parimin e funksionimit të komisioneve. Kjo duhet të vlejë për të gjitha komisionet, ndryshe do ta dëmtonim seriozisht mandatin e komisioneve.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ky komision e vlerëson një punë në Parlament, një veprim, a është konform Kushtetutës a jo, projekti i Kushtetutës është mendim yti dhe ky parlament ka me vendosur sigurisht,. Thashë parimet që do të përipiqemi të jenë njerëzit më më autoritet që ka Kosova edhe në Parlament edhe në shoqërinë civile edhe në institucionet e jurisprudencës edhe të shkencës edhe të të gjithave ,prandaj ky kuvend, kjo seancë do të vendosë, pra nuk është në rend dite ajo. Profesor Alush Gashi, urdhëroni

DEPUTETI ALUSH GASHI

Grupi parlamentar LDK-së e ka shqyrtuar çështjen e arritjeve gjatë kësaj legjislature dhe detyrat që më parë janë marrë përsipër për çështjet për të cilat diskutohet sot. Fillimisht jemi deklaruar dhe fuqimisht qëndrojmë në atë se jemi për transparencë të plotë dhe për mbikëqyrje demokratike të institucionit të Kosovës, ashtu si e përcolli deputeti Sabri Hamiti, na vjen shumë mirë që Qeveria e Kosovës të vijë në seancë plenare dhe ta paraqes rezultatin e të gjitha arriturave të ashtuquajtura standarde, aq më tepër kur me vlerësime individuale të atyre, 8 fushave, ne dita ditës jemi dëshmitarë të evidencimit të rezultateve të kënaqshme në disa lami dhe në disa rezultate shumë të mira.

Sa i përket çështjes së dytë, të ngritur nga ana e opozitës ne e mirëpresim iniciativën që të kemi raport të thuktë dhe shumë transparent lidhur me atë se deri ku ka arritur privatizimi në Kosovë. Jemi shumë të interesuar që të dëgjojmë për fatin e pasurisë sonë kombëtare, në veçanti çështjen e minierave të Kosovës.

Z. Kryetar, në emër të grupit insistojmë që përgatitja për debat të jetë e plotë dhe të jetë sipas rregullores, me të cilën e punojmë, ne shpesh kemi iniciativa që këtu të bisedohet pa pasur rekomandime se çka pritet prej debati dhe pa pasur një rrëzime në rekomandime pas debatit, prandaj ju lutem që materiali me shkrim të na vijë me kohë për çështje të cilat u iniciuan që ne si grup parlamentar i mbështesim dhe i presim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Profesor ju faleminderit.
Ramadan Kelmendi i fundit, urdhëroni Ramadan

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI

Desha ta ngre një çështje, gjegjësisht ta riaktivizoj çështjen e kartelave të deputetit, Komisionit për Kornizë Kushtetuese dhe legjislacionin i ka arritur një amendament nga disa deputetë që kanë kërkuar që kjo kartelë për vitin në vijim, pra 2006, të jetë në harmoni me imunitetin e deputetit. E kemi proceduar në Kryesinë e Kuvendit, por deri më sot më se 4 muaj, nuk kemi marrë përgjigje. Lus që vërtet ajo të jetë në harmoni dhe në pajtueshmëri të plotë me atë që i takon deputetit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ramadan, ju faleminderit. Të shpresojë për sukses, por le të procedohet dhe le të aktualizohet të jepet përgjigja, sepse tjetërkush po vendos, jo institucionet. Ju faleminderit. Shihemi në seancën e radhës.